

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**



**Fakulteti i Drejtësisë**  
**Правен факултет**  
**Faculty of Law**

**E DREJTA CIVILE**

**PUNIM MAGJISTRATURE**

**TEMA:**

**„RESPEKTIMI I INTERESIT TË FËMIJËS PËRMES  
INSTITUTIT TË PRINDËRISË SË PËRBASHKËT PAS  
SHKURORËZIMIT”**

**Kandidat: Fatmire Azizi**

**Mentor: Doc. dr. Arta Selmani-Bakiu**

**Tetovë, 2020**



## **DEKLARATA E AUTORIT**

**Unë, Fatmire Azizi, studente pranë Fakultetit Juridik në Universitetin e Europës Juglindore-Tetovë, deklaroj se jam autore e punimit dhe mbaj përgjegjësi për origjinalitetin e këtij punimi.**

**Fatmire Azizi**

---

**Lektoroi :**

**Doc. dr. Luljeta Adili-Çeliku**

## **ABSTRAKT**

Pasojat më të rënda të shkurorëzimit i përjetojnë fëmijët. Në vendimin për zgjidhjen e martesës, gjykata duhet të vendosë se cili prej prindërve do të ketë kujdestarinë kryesore për fëmijët.

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë dhe të hulumtojë cilësinë e marrëdhënieve prind-fëmijë pas shkurorëzimit të martesës nga perspektiva e vlerësimit të situatës reale, si dhe procedurat për tejkalimin e pengesave për realizimin e suksesshëm të kontaktit të fëmijëve me prindin pas shkurorëzimit për hir të rritjes dhe zhvillimit të duhur të mëtutjeshëm të fëmijëve.

Metodologjia e këtij hulumtimi do të bazohet në përgjithësi në metodat kualitative, analitike, intervistës, krahasuese, deskriptive dhe empirike. Për mbledhjen e të dhënave janë realizuar gjithsej 3 intervista të thelluara gjysmë të strukturuar, me persona të punësuar pranë Qendrës për Punë Sociale në Kërçovë.

Metoda krahasuese do të ketë një rëndësi të posaçme, për shkak se do të më ndihmojë që të bëj një krahasim midis prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit në vendet ku ky institut është treguar tejet i suksesshëm për tejkalimin e problemeve midis prindërve të shkurorëzuar dhe fëmijës.

## **ABSTRACT**

The gravest consequences of divorce are experienced by the children. In the marriage settlement agreement decision, the court must promptly rule which parent shall receive main custody (or legal guardianship) for the children.

The purpose of this study is to explore the quality of parent-child relationships after divorce from the perspective of assessing the real situation, as well as the procedures for overcoming obstacles to the successful realization of children's contact with the parent after divorce for the sake of further growth and development of children.

The research method applied is the qualitative one. The methodology will generally be qualitative, analytical, interview, comparative, descriptive and empirical methods. For the collection of data, a total of 3 in-depth semi-structured interviews were conducted with persons employed at the Center for Social Work in Kichevo.

The comparative method will be of particular importance because it will help me make a comparison between the common parent after divorce in countries where this institute has been shown to be extremely successful in overcoming problems between divorced parents and the child.

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                  |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| ABSTRAKT .....                                                                                                                   | 4  |
| ABSTRACT .....                                                                                                                   | 5  |
| I. Qëllimi i punimit.....                                                                                                        | 8  |
| II. Përmbajtja e punimit .....                                                                                                   | 9  |
| III. Metodologjia e hulumtimit .....                                                                                             | 10 |
| IV. Lënda e hulumtimit .....                                                                                                     | 11 |
| V. Hipoteza .....                                                                                                                | 12 |
| 1 HYRJE.....                                                                                                                     | 13 |
| 2 SHKURORËZIMI .....                                                                                                             | 15 |
| 2.1. Shkurorëzimi i martesës në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....                                                          | 15 |
| 2.3. Marrëdhëniet familjare pas shkurorëzimit .....                                                                              | 19 |
| 3 USHTRIMI I SË DREJTËS PRINDËRORE .....                                                                                         | 21 |
| 3.1. Prindëria pas shkurorëzimit të martesës në Republikën e Maqedonisë së Veriut ....                                           | 21 |
| 3.2. Mbikqyrja mbi ushtrimin e së drejtës prindërore .....                                                                       | 24 |
| 3.3. Pushimi dhe vazhdimi i së drejtave prindërore.....                                                                          | 25 |
| 3.3.1. <i>Pushimi i së drejtës prindërore</i> .....                                                                              | 25 |
| 3.3.2. <i>Vazhdimi i së drejtës prindërore</i> .....                                                                             | 26 |
| 4. DOUMENTET NDËRKOMBETARE QË GARANTOJNË PRINDËRINË E PËRBASHKËT .....                                                           | 27 |
| 4.1. Konventa e OKB-së Për të Drejtat e Fëmijës.....                                                                             | 27 |
| 4.2. Charter of fundamental rights of the EU – Karta e të Drejtave Themelore të BE-së.....                                       | 27 |
| 4.3. European Convention on the Exercise of children's rights – Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve ..... | 28 |
| 4.4. Convention on contact concerning children – Konventa për Kontaktin në Lidhje me Fëmijët.....                                | 28 |
| 4 MODELET E NDRYSHME TË PRINDËRIS SË PËRBASHKËT PAS SHKURORËZIMIT TË MARTESËS.....                                               | 29 |

|        |                                                                            |    |
|--------|----------------------------------------------------------------------------|----|
| 4.2.   | Efekti i Joint Physical Custody te prindërit .....                         | 31 |
| 4.3.   | Efekti i Joint Custody në mirëqenien e fëmijës .....                       | 31 |
| 5      | NDIKIMI I SHKURORËZIMIT TE FËMIJËT .....                                   | 33 |
| 5.1.   | Mirëqenia e fëmijës dhe prindëria e përbashkët .....                       | 33 |
| 5.1.1. | <i>Mirëqenia e fëmijës</i> .....                                           | 33 |
| 5.2.   | Marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit.....                           | 35 |
| 5.3.   | Ndikimi i shkurorëzimit te sjellja e fëmijëve .....                        | 37 |
| 5.4.   | Prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit sipas Legjislacionit Gjerman..... | 39 |
| 6      | METODOLOGJIA .....                                                         | 42 |
| 6.1.   | Metodologjia e hulumtimit.....                                             | 42 |
| 6.1.1. | <i>Analiza e intervistës</i> .....                                         | 43 |
| 7      | Rezultatet e intervistës .....                                             | 44 |
| 7.1.   | Intervista 1.....                                                          | 44 |
| 7.2.   | Intervista 2.....                                                          | 47 |
| 7.3.   | Intervista 3.....                                                          | 50 |
| 8      | PËRMBLEDHJA DHE KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË PËRFITUARA NGA INTERVISTAT.....  | 52 |
| 8.1.   | Krahasimi i të dhënave të përfituara nga intervistat .....                 | 52 |
| 9      | STATISTIKA PËRSHKRUESE PËR NUMRIN E SHKURORËZIMEVE NË KËRÇOVË.....         | 56 |
| 10     | PËRFUNDIMI .....                                                           | 57 |
|        | BIBLIOGRAFIA .....                                                         | 59 |
|        | AKTET JURIDIKE.....                                                        | 62 |
|        | BURIME NGA INTERNETI.....                                                  | 63 |

## **I. Qëllimi i punimit**

Qëllimi shkencor i hulumtimit është të studiojë cilësinë e marrëdhënieve prind-fëmijë pas shkurorëzimit të martesës nga perspektiva e vlerësimit të situatës reale, si dhe procedurat për tejkalimin e pengesave për realizimin e suksesshëm të kontaktit të fëmijëve me prindin pas shkurorëzimit për hir të rritjes dhe zhvillimit të duhur të mëtutjeshëm të fëmijëve.

Shumë prindër edhe pas shkurorëzimit vazhdojnë të përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre me angazhim të plotë ndaj fëmijëve të tyre si dhe me respekt ndaj prindit tjetër. Por fakt është, që ka edhe prindër të cilët me një sfidë të tillë nuk mund të ballafaqohen. Konfliktet e vazhdueshme ose paaftësia e komunikimit të mirëfilltë bllokojnë kompetencat e vendimmarrjes rreth nevojave të fëmijës por dhe i rëndojnë marrëdhëniet në të gjithë familjen. Prindërit që janë në gjendje të tillë e kanë shumë të vështirë në marrjen e vendimeve të përbashkëta.

Të gjithë fëmijët kanë nevojë për marrëdhënie të qëndrueshme dhe të besueshme me nënën dhe babanë - edhe në raste gjatë ndarjes dhe divorcit. Procese të tilla nuk mund t'i rregullojë asnjë ligj, por mund të sigurojë një kornizë, që mbështet bashkëpunimin midis të dy prindërve. Kjo paraqet bazën fundamentale për një zhvillim të shëndoshë.

Hulumtimi fokusohet në gjendjen aktuale të kujdestarisë së fëmijës pas shkurorëzimit, problemet që shfaqen nga kjo kujdestari monoprinërore, të cilat probleme në veçanti reflektohen te fëmijët, konfliktet e vazhdueshme mes prindërve lidhur me realizimin e kontakteve me prindin me të cilin nuk jeton fëmija, duke rekomanduar në këtë drejtim zgjidhjet që ofrojnë legjislacionet familjare bashkëkohore të cilët promovojnë kujdestarinë e përbashkët të fëmijëve pas shkurorëzimit.



## II. Përmbajtja e punimit

Punimi „Respektimi i interesit të fëmijës përmes institutit të prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit” katetë kapituj. Në hyrje përfshihen çështje të cilat kanë të bëjnë me lëndën dhe me qëllimin e këtij studimi, hipotezat si dhe organizimin e punimit.

Kapituli i dytë paraqet një rishikim të shkurorëzimit në bazë të legjislacionit të RMV-së, poashtu po në këtë kapitull trajtohen marrëdhëniet familjare pas shkurorëzimit si dhe pasojat e shkurorëzimit të fëmijët.

Në kapitullin e tretë, „Ushtrimi i së drejtës prindërore” përshkruhet ushtrimi i së drejtës prindërore pas shkurorëzimit të martesës në RMV, Mbikqyrja mbi ushtrimin e së drejtës prindërore si dhe ndalimi dhe vazhdimi i të drejtave prindërore.

Kapitulli i katërt merret me përshkrimin e modeleve të prindërisë së përbashkët. Po në këtë kapitull paraqiten nocionet „joint legal custody” dhe „joint physical custody” që të dy janë pjesë e „joint custody”. Nëse bëhet fjalë për „joint custody”, atëherë duhet dalluar, nëse bëhet fjalë për „prindëri të përbashkët ligjore/juridike” (joint legal custody) (prindërit bashkarisht janë përgjegjës për jetën e fëmijës), ose për „përkujdesje materiale e përbashkët” (joint physical custody).

Kapitulli i pestë, „Ndikimi i shkurorëzimit të fëmijët” është një nga pjesët më të rëndësishme të këtij punimi, në të trajtohen shumë tema të rëndësishme si: mirëqenia e fëmijës, marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit, ndikimi i shkurorëzimit të sjellja e fëmijëve si dhe prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit që është edhe qëllimi i këtij punimi.

Në kapitullin e gjashtë është paraqitur metodologjia e punimit që është përdorur për këtë studim. Kështu, për pjesën sasiore të studimit, janë dhënë: qëllimi i studimit, struktura e kërkimit, pyetjet e kërkimit, përcaktimi i variablave të studimit, personat e të hequr në studim, si dhe mbledhja e të dhënave si dhe procedurat e analizave të përdorura. Kurse për pjesën cilësore të studimit, janë trajtuar: zgjedhja e pjesëmarrësve në studim, forma e intervistës të përdorur, konsiderata etike, pjesëmarrësit e studimit, metoda e regjistrimit të të dhënave dhe analiza e të dhënave.

Në kapitullin e shtatë janë paraqitur rezultatet e intervistës së realizuar. Kapitulli i tetë në vete përmban krahasim dhe përmbledhje të intervistave të realizuara. Në fund të punimit është përmbajtja, pyetjet e intervistës të shënuara si shtojcë, si dhe bibliografia që shërbeu për ta përmbledhur këtë tezë magjistrature.

### **III. Metodologjia e hulumtimit**

Ky studim fokusohet në rëndësinë e zbatimit të prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit si një mekanizëm ligjor dhe social, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm fizik dhe psikik të fëmijëve që i përjetojnë ose i kanë përjetuar pasojat e shkurorëzimit të prindërve.

Në këtë pjesë të metodologjisë do të paraqiten elemente mjaft cilësore të studimit të tillë, si: formati i intervistës së përdorur, konsiderata etike, pjesëmarrësit e hulumtimit, metoda e mbledhjes së të dhënave, përfundimi i mbledhjes së të dhënave si dhe analiza e të dhënave.

Gjatë këtij hulumtimi shkecor do aplikoj metodat më të përshtatshme që i përgjigjen temës së lartëpërmendur, me qëllim që të arrij deri te qëllimi i hulumtimit.

Metodologjia e këtij hulumtimi do bazohet në përgjithësi në metodat: kualitative, analitike, intervistes, krahasuese, deskriptive dhe empirike.

Metoda krahasuese do të ketë një rëndësi të posaçme, për shkak se do të më ndihmojë që të bëj një krahasim midis prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit në vendet ku ky institut është treguar tejet i suksesshëm për tejkalimin e problemeve midis prindërve të shkurorëzuar dhe fëmijës.

Gjatë hulumtimit do të shfrytëzoj literaturë si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhët: maqedone, angleze dhe gjermane ndër të cilët: ligje, libra shkencor, konventa, doracakë por dhe fjalorë. I gjithë hulumtimi do jetë i ndarë në kapituj dhe në nënkapituj.

**Te dhënat dhe informatat e rëndësishme nga praktika juridike:**

Janë intervistuar persona të punësuar pranë Qendrës për Punë Sociale. Hulumtimi është bërë nëpërmjet një pyetësoi. Në pyetësor janë parashtruar pyetje nga më të ndryshmet rreth ushtrimit të së drejtës prindërore pas shkurorëzimit të martesës, marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit si dhe reagimi i fëmijëve gjatë dhe pas shkurorëzimit. Personat e hulumtuar janë të profesioneve të ndryshme, si: jursit, pedagog dhe psikolog.

#### **IV. Lënda e hulumtimit**

Lënda e hulumtimit e këtij punimi është ushtrimi i së drejtës prindërore pas shkurorëzimit sipas legjislacionit familjar të RMV, pra marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës, si lëndë e hulumtimit të këtij punimi do të jenë edhe situatat dhe problemet për ushtrimin e së drejtës prindërore pas shkurorëzimit të martesës, problemet e zakonshme që i vështirësojnë marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit si dhe efikasitetin e formave dhe procedurave midis prindërve për të krijuar marrëdhënie pozitive me fëmijët e tyre pas shkurorëzimit.

Gjithashtu, lëndë e këtij punimi do të jetë edhe nevoja për inkorporimin e institutit të prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit, me qëllim që fëmija të ketë kontakte dhe raporte të vazhdueshme edhe pas ndarjes së prindërve.

Respektimi i interesit të fëmijës paraqet imperativ kryesor në raportin prind- fëmijë, dhe si i tillë duhet të ngelë edhe pas shkurorëzimit.

Përgjegjësia e përbashkët e prindërve për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës realizohet nëpërmjet ushtrimit të së drejtës prindërore, e cila u përket në mënyrë të barabartë të dy prindërve.

## **V. Hipoteza**

Prindëria e përbashkët paraqet institut i cili ndikon pozitivisht në mirëqenien psikosociale të fëmijës, pas ndarjes së prindërve .

Prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit krijon lidhshmëri më të qëndrueshme midis fëmijës dhe prindërve.

Pas shkurorëzimit prindërit vazhdojnë të mbesin të përbashkët edhe pse marrëdhënia martesore ka mbaruar.

Me anë te institutit të prindërisë së përbashkët vjen në shprehje parimi i respektimit të interesit më të lartë të fëmijës.

## 1 HYRJE

Martesa është institucion i rëndësishëm social dhe juridik që nënkupton një sistem të përcaktuar të drejtash dhe detyrimesh reciproke për bashkëshortët në raport me njëri-tjetrin dhe me fëmijët. Lidhja e martesës bazohet në disa parime të rëndësishme siç janë: barazia morale dhe juridike e bashkëshortëve, ndjenja e dashurisë, e mirëkuptimit dhe respektit reciprok të cilat, përbëjnë bazën e zhvillimit të saj. Pavarësisht mekanizmave ligjorë që mbrojnë martesën, bashkëshortët, fëmijët dhe që ndikojnë në zhvillimin harmonik të familjes, në gjithë botën mbetet e ekspozuar ndaj një fenomeni social të pashmangshëm, shkurorëzimit.

Shkurorëzimi ndodh vetëm atje dhe atëherë kur ekziston martesa.<sup>1</sup> Në vitet e fundit vihet re qartë se numri i bashkëshortëve që vendosin të shkurorëzohet gjithmonë e më tepër shkon drejt rritjes dhe numri i fëmijëve me prindër të shkurorëzuar është në rritje. Shkaqet që ndikojnë në rritjen e numrit të shkurorëzimit janë të natyrave të ndryshme, duke i dhënë kështu këtij fenomeni një karakter shumëdimensional. Gjithashtu, edhe pasojat e shkurorëzimit janë shumëdimensionale, që kanë ndikim të fortë për prindërit, por mbi të gjitha për fëmijët. Fëmijët e përjetojnë shumë ndarjen e prindërve dhe ekspozohen përballë faktorëve të rrezikut që ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e tyre.

Zakonisht, fëmijët pas ndarjes, lihen nën kujdestarinë e njërit prind, me të drejtë për të vizituar rregullisht prindin tjetër në afate të mirëcaktuara ligjore. Kujdestaria e një fëmije është vendimi më kritik i prindërve që kanë vendosur për shkurorëzim. Dikush mund të haset në lloje të ndryshme të kujdestarive, si: në kujdestarinë e përbashkët dhe në kujdestarinë monoprinëdore. Megjithatë të dy termet i referohen kujdestarisë së fëmijëve, ato në mes kanë dallimet e tyre.

Kujdestaria monoprinëdore nënkupton që vetëm njëri prind ka të drejtë të marrë vendime, kurse prindi tjetër është i obliguar të paguajë alimentacionin. Nga ana tjetër, kujdestari e përbashkët do të thotë: të dy prindërit kanë të drejta të barabarta në vendimet në lidhje me fëmijën e tyre. Prindërit që ndajnë prindërinë e përbashkët dhe së bashku kanë qasje

---

<sup>1</sup>Martesa është bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen intresat e bashkëshortëve familjes dhe shoqërisë.

në: të dhënat shkollore, të dhënat shëndetësore, regjistrimet e drejtimit dhe në çdo të dhënë tjetër të fëmijës. Të gjitha vendimet kryesore, si: studimet e larta, operacionet, udhëtimet nëpër shtetet e huaja dhe shpenzimet e tjera duhet të miratohen nga të dy prindërit. Mbi fëmijën, prindëria e përbashkët ndikon në forma dhe metoda të ndryshme sidomos në mirëqenien e fëmijës.

Në veçanti për mirëqenien e fëmijës, përveç nevojave themelore, përmendet edhe stabiliteti i marrëdhënieve mes fëmijës dhe prindërve. Përveç plotësimit të nevojave themelore fizike, si: ushqimi, kujdesi, ngrohtësia, higjena dhe kujdesi mjekësor paraqiten edhe nevoja për shoqërim njerëzor, nevoja për dashuri, afërsi si dhe pranim. Këto nevoja mund të zgjojnë reagime dhe sinjale të ndjeshme te fëmijët.

Rëndësia e këtij punimi është që të vë në dukje nevojën për plotësime dhe ndryshime në legjislacionin familjar në pjesën e ndarjes së kujdestarisë së fëmijëve pas shkurorëzimit. Dispozitat aktuale ligjore diskriminojnë së pari fëmijën, pastaj edhe prindin i cili nuk fiton kujdestarinë. Me këtë fëmija humb njërin prind, me të cilin kontaktet i ka të limituara dhe për terminet e të cilave vendos Qendra për Punës Sociale. Çështja e termineve për mbajtjen e kontakteve është një nga temat më të hidhura gjatë procesit të shkurorëzimit. Dispozitat ligjore aktuale thellojnë edhe më tepër konfliktin ndërprindëror, mu për shkak se prindi që fiton kujdestarinë, „fiton” edhe fuqinë që të cënojë të drejtën e prindit tjetër për ta kontaktuar fëmijën e vet.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup>Selmani, A., (2018), Prindër të ndarë, fëmijë të përbashkët. <https://portalb.mk/497528-prinder-te-ndare-femije-te-perbashket/> (22.05.2020)

## 2 SHKURORËZIMI

### 2.1. Shkurorëzimi i martesës në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Shkurorëzimi është mekanizmi ligjor përmes të cilit palët ndryshojnë statusin e tyre juridik nga të martuar në të pamartuar.

Në bazë të dispozitave të nenit 6 të Ligjit për familje, martesë është bashkësia jetësore e një burri dhe gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë, bazuar në barazinë, respektin e ndërsjelltë dhe ndihmën reciproke. Në bazë të kësaj, nëse marrëdhëniet martesore nuk zhvillohen sipas konceptit të lartëpërmendur të martesës ose sipas pritjeve të bashkëshortëve, njëri prej tyre ose të dy, në shoqëritë moderne, është e lejuar që marrëdhënia e tillë martesore edhe gjatë jetës së bashkëshortëve, të mundën ta ndërpresin martesën e tyre duke e shkurorëzuar në mënyrë ligjore, me procedurë dhe vendim të organit që është paraparë me ligj.<sup>3</sup> Shkurorëzimi është pasojë e mosmarrëveshjeve dhe grindjeve permanente midis partnerëve. Bashkëshortët mund të shkurorëzohen me marrëveshje të ndërsjelltë. Pra, bashkëshortët mund të kërkojnë zgjidhjen e martesës me marrëveshje nëse ata janë marrë vesh njëri me tjetrin për zgjidhjen e saj.

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, është e nevojshme që të parashtrorjnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve.<sup>4</sup>

Në të drejtën bashkëkohore ekziston evolucion për shkaqet dhe mundësitë e shkurorëzimit të martesës, kështu që ekziston tendencë për liberalizim më të madh por gjithnjë nën kontrollin e organit shtetrorë.

Shkurorëzimi paraqet një nga mënyrat më të shpeshta të zgjidhjes së martesës së vlefshme. Kur marrëdhëniet martesore do të jenë keqësuar aq shumë me çka bashkëjetesa do

---

<sup>3</sup>Çavdar, K., Siljanoska-Kostadinovska, C., (2013), *Закон за семејството коментари, судска практика, предметен регистар за практична примена, придружни прописи и литература*, Sv. Kliment Ohridski, Skopje, fq.126.

<sup>4</sup>Neni 39, paragrafi 1 dhe 2, *Ligji për Familje i RMV-së*.

të jetë e padurueshme, lejohet që jetesa e përbashkët të pushojë me shkurorëzim, në bazë të kushteve dhe mënyrave të parapara me ligj. Sipas kësaj, shkurorëzimi i martesës paraqet mënyrën e vlefshme të zgjidhjes së martesës në kohën e jetesës së bashkëshortëve me vendim të gjyqit, përderisa janë përmbushur shkaqet e parapara me ligj.

Duke u nisur nga ajo që është thënë më lart, dalin disa karakteristika kryesore të shkurorëzimit të martesës. Së pari, me shkurorëzim mund të pushojë vetëm martesa e vlefshme, në të kundërtën, nëse vërtetohen se nuk janë plotësuar kushtet për lidhjen e martesës ose ekzistojnë pengesa martesore, martesa do të anulohet. Së dyti, martesa mund të shkurorëzohet vetëm gjatë kohës së jetës. Bashkëshortët duhet të jenë gjallë gjatë gjithë procedurës, prej dorëzimit të padisë deri në plotëfuqishmërinë e vendimit për shkurorëzim të martesës. Me vdekjen e njërit bashkëshort martesa përfundon sipas fuqisë së ligjit, sepse procedura e shkurorëzimit ndërpritet. E treta, martesa mund të shkurorëzohet vetëm me vendim të organit kompetent, me procedurë të paraparë me ligj. Kjo karakteristikë e shkurorëzimit si mënyrë juridike e pushimit të vlefshëm të martesës del prej faktit që martesa paraqet institucion juridik dhe shoqëror. Për këtë arsye bashkëshortët pa pjesëmarrëjen e organit kompetent (gjyqit) nuk mund të shkurorëzohen. E katërta, martesa mund të shkurorëzohet vetëm nëse ekzistojnë arsyet e parapara me ligj.<sup>5</sup>

Kur shkurorëzimi është i lejuar me të drejtën pozitive, bashkëshortët janë të autorizuar në të drejta të barabarta (të dy bashkëshortët kanë të drejtë të kërkojnë shkurorëzimin e martesës). Shkurorëzimi është e drejtë e patjetërsueshme dhe e pacënueshme e çdo individi.<sup>6</sup>

Në teori dhe praktiken legjislativë janë të njohura disa sisteme të shkurorëzimit të martesës. Ne varësi të asaj a lejohet shkurorëzimi i martesës ose nuk lejohet dhe nëse shkaku i shkurorëzimit është faji i njërit prej bashkëshortëve, njihen:

- Sistemi që e ndalon shkurorëzimin;
- Sistemi që e lejon shkurorëzimin;
- Sistemi i shkurorëzimit-sanksion;

---

<sup>5</sup>Trpenovska, S.L., Micković, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 136.

<sup>6</sup>Podvorica, H., (2005), *E drejta familjare*, Prishtinë, fq. 118.



- Sistemi i shkurorëzimit si ilaç juridik
- Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit.

## **2.2. Arsyet e shkurorëzimit të martesës në Ligjin familjar të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Në teorinë juridike arsyet e shkurorëzimit të martesës përcaktohen si fakte ose ngjarje të cilat ligji i parasheh si bazë për shkurorëzimin e martesës. Përcaktimi i arsyeve për shkurorëzimin e martesës varet nga numri i faktorëve, si: shkalla e zhvillimit shoqëror, religjioni, qëndrimet morale dhe etike, ndikimi i traditave dhe zakoneve, marrëdhëniet e fuqive politike dhe faktorë të tjerë. Legjislacioni ynë familjarë parasheh tri arsye për të cilat martesa mund të shkurorëzohet:

- a. Arsyeja e parë e shkurorëzimit të martesës është marrëveshja e ndërsjelltë e bashkëshortëve. Marrëveshjen e ndërsjelltë për shkurorëzimin e martesës bashkëshortët e shprehin me propozimin për shkurorëzim të martesës në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë deri te gjykata kompetente. Marrëveshjen e tillë të bashkëshortëve, ligjvënësi e kushtëzon me dorëzimin e marrëveshjes për mënyrën e ushtrimit të së drejtës prindërore si dhe detyrimin, mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve, e cila doemos duhet të jetë e qartë dhe plotësisht e përcaktuar. Marrëveshja e tillë dorëzohet me shkrim ose gojarisht në procesverbal pranë gjykatës kompetente. Gjatë vlerësimit të marrëveshjes, gjykata është e detyruar të marrë mendim nga Qendra për Punë Sociale nëse ajo është në interes të fëmijëve. Ky kusht është i domosdoshëm në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët ose fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore. Në të kundërtën, bashkëshortët nuk kanë detyrim për dorëzimin e marrëveshjes së tillë.<sup>7</sup> Gjykata do të sjellë vendim për shkurorëzimin e martesës në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë të bashkëshortëve nëse vërtetohet se ata atë pajtim e kanë arritur në mënyrë të lirë, serioze dhe të pakthyeshme.<sup>8</sup>

<sup>7</sup>Trpenovska, S. L., Micković, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 140.

<sup>8</sup>Neni 39, paragrafi 3, Ligji për familje i RVM.

- b. Arsyeja e dytë e shkurorëzimit të martesës mund të bëhet me kërkesë të njërit bashkëshort. Në pajtim me Ligjin për familje, martesa mund të shkurorëzohet me kërkesë të njërit bashkëshort nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë të çrregulluara deri në atë masë sa që jeta epërbashkët është bërë e padurueshme. Rëndësia e kësaj arsyeje bazohet në rrethana objektive e jo kontributin subjektiv të bashkëshortëve në një situatë të tillë. Marrëdhëniet e çrregulluara edhe pse nuk mundet në mënyrë të përpiktë të definohen, paraqesin rrethana objektive të cilat vlerësohen në bazë të kritereve të ndara në mesin ku jetojnë bashkëshortët si dhe në bazë të standardeve të pranuar përgjithësisht në marrëdhëniet njerëzore.<sup>9</sup>
- c. Arsyeja e tretë e shkurorëzimit është pushimi faktik i bashkësisë martesore, nëse ajo ka pushuar së ekzistuari më tepër se një vit. Mosfunksionimi i bashkësisë martesore në periudhë prej një viti është kusht i mjaftueshëm për ndarjen e asaj bashkësie.

Një nga pyetjet më të rëndësishme të pas shkurorëzimit të martesës është vendimi për ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve. Kjo vlen për fëmijet e mitur si edhe për fëmijet madhorë të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore. Nëse prindërit arrinë të merren vesh rreth mënyrës së ushtrimit të së drejtës prindërore pas shkurorëzimit të martesës, gjyqi do ta pranojë marrëveshjen e tyre nëse ajo është në pajtim me interesat e fëmijëve. Rolin kryesor në vlersimin e rrethanave konkrete sipas rregullave tona e kryen Qendra për Punë Sociale. Ekipet e ekspertëve të Qendrës (psikologët, pedagogët, punuesit social, juristët), kanë mendime në të cilat mbështetet gjykata para sjelljes së vendimit.<sup>10</sup>

Pavarsisht asaj se cilit nga të dy prindërit do ti besohen fëmijët, detyrimi për mbajtjen e tyre është i përbashkët. Caktimi i lartësisë së kontributit për mirëmbajtjen e tyre realizohet në pajtim me nevojat e fëmijëve por gjithashtu merret parasysh edhe mundësia materiale e prindit që jep alimentacionin.

---

<sup>9</sup>Trpenovska, S. L., Micković, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 141.

<sup>10</sup>Trpenovska, S. L., (2004), *Семејно прав*, Blesok, Skopje, fq. 140.

Vendimi për ruajtjen dhe mbajtjen e fëmijëve, mund të ndryshohet nëse për atë parashtrijnë kërkesë prindërit e shkurorëzuar ose njëri prej tyre apo, nëse atë e kërkon Qendra për Punë Sociale në bazë të njohurive dhe vlerësimit që ka për nevojat e ndryshimit të till.<sup>11</sup>

### **2.3. Marrëdhëniet familjare pas shkurorëzimit**

Bashkëshortët janë ata të cilët duhet të bartin pasojat e përfundimit të martesës së tyre me anë të shkurorëzimit, duke mos lejuar që ata të njëjtat të reflektohen te fëmijët. Juridikisht një gjë e tillë nuk është e mundur. Fëmijët ndikohen nga kjo ndarje, nga vetë fakti që ata janë të detyruar të jetojnë me njërin prind. Shkurorëzimi, ka pasoja lidhur me: mbiemrin, trashëgiminë, ndarjen e pasurisë së përbashkët, alimentacionin (ndarjen e mbajtjes bashkëshortit të pasiguruar materialisht), çështjen e banimit, pagimit të shpenzimeve procedurale, çështja e dëmshpërblimit të ndonjë dëmi eventual, etj. Kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, personeli profesional i Qendrës për Punë Sociale udhëheq procedurën për pajtimin e bashkëshortëve. Nëse seanca për pajtimin e bashkëshortëve është e pasuksesshme atëherë ekipi profesional i Qendrës për Punë Sociale jep mendimin dhe propozimin për ruajtjen, edukimin e fëmijëve, dhe bazuar në faktet dhe të dhënat profesionale, gjykata në seancën kryesore vendos edhe për edukimin, ushqimin dhe ruajtjen e fëmijëve.<sup>12</sup>

Edhe pse fëmijët i ndahen njërit prind, me anë të shkurorëzimit nuk mund të ndërpritet marrëdhënia prindërore, ajo marrëdhënie familjare midis fëmijëve dhe prindërve ekziston edhe pas ndarjes. Çiftet të cilët kanë fëmijë dhe të cilët kanë vendosur të jetojnë të ndarë, duhet të vazhdojnë të sjellin vendime të përbashkëta sa i përket mirërritjes dhe edukatës familjare të fëmijës. Shkurorëzimi në të shumtën e rasteve nuk ndikon negativisht te fëmijët që jetojnë ndaras nga njëri prind, në krahasim me mosmarrëveshjen dhe grindjet e vazhdueshme që mund të kenë çiftet. Edhe pse të ndarë nga fëmijët, çiftet vazhdojnë të jenë prindërit e tyre përkundër mos koordinimeve që kanë ndërmjet vete për çështje tjera jetësore, mirëpo, në çdo vendimarrje të tyre në prioritet duhet të kenë interesin më lartë të fëmijëve. Pasojat

<sup>11</sup>Trpenovska,S.L,(2004), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 141.

<sup>12</sup>[http://www.ajls.org/doc/9.%20ASelmani\\_Shkurorezimi.pdf](http://www.ajls.org/doc/9.%20ASelmani_Shkurorezimi.pdf)(11.02.2020).

Selmani, A., (2009), Ndhima juridike pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, fq. 10.

personale të shkurorëzimit duhet të ndikojnë drejtpërdrejtë te ish-bashkëshortët, e assesi te fëmijët, sepse ata nuk janë aspak fajtorë për situatën jetësore që ua krijojnë prindërit.<sup>13</sup>

Edhe pse shkurorëzimi është një nga alternativat më të dhimbshme për fëmijët, në situata të veçanta paraqet zgjidhje të vetme në një martesë ku mbisundon grindja e jo marrëveshja. Fëmijët të cilët kalojnë nëpër fazën e ndarjes së prindërve, duhet të jenë të bindur se ata vazhdojnë të kenë dashurinë dhe vëmendjen prindërore dhe se një ndarje e tillë bëhet për një jetë më të qetë të cilën prindërit nuk kanë mundur t'ua ofrojnë. Në disa raste fëmijët janë motivimi dhe arsyeja e vetme për t'i mbyllur sytë ndaj mosmarrëveshjeve. Disa çifte sakrifikojnë „lumturinë“ e tyre dhe vazhdojnë të bashkëjetojnë në mungesë të dashurisë së ndërsjelltë. E gjithë kjo sakrificë bëhet duke pasur synim kryesor lumturinë e fëmijëve të tyre dhe duke mos i sprovuar me pjesën më të dhimbshme - ndarjen nga ata.<sup>14</sup>

Pas shkurorëzimit të martesës fëmijëve si edhe prindërve u nevojitet shumë fuqi, që të përshtaten me situatën e re jetësore. Ato mund të përballen me shumë probleme praktike, për shembull: ndryshimet financiare, vendbanimi, strehimi dhe ndryshimi i shkollës, organizimi i kujdesit për fëmijët e mitur, si edhe të fëmijëve të rritur, marrëveshja dhe pajtueshmëria me rregulloret e vizitave si dhe mosmarrëveshjet me ish-partnerin.<sup>15</sup>

Shkurorëzimi i martesës i jep fund marrëdhënies juridike që ka lindur ndërmjet bashkëshortëve si rezultat i lidhjes së martesës. Pasojat kanë si rezultat shuarjen, ndryshimin apo krijimin e disa të drejtave dhe detyrimeve mes ish-bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre. Në bazë të kriterit të objektit të pasojave, që rrjedhin pas zgjidhjes së martesës, si në rastin emarrëdhënies ndërmjet ish-bashkëshortëve ashtu edhe të marrëdhënies prindërore, dallojmë: pasojat personale jopasurore dhe pasojat pasurore.<sup>16</sup>

---

<sup>13</sup>[http://www.aijs.org/doc/9.%20ASelmani\\_Shkurorezimi.pdf](http://www.aijs.org/doc/9.%20ASelmani_Shkurorezimi.pdf)(11.02.2020).

Selmani, A., (2009), Ndhima juridike pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, fq. 11.

<sup>14</sup>[http://www.aijs.org/doc/9.%20ASelmani\\_Shkurorezimi.pdf](http://www.aijs.org/doc/9.%20ASelmani_Shkurorezimi.pdf)(11.02.2020).

Selmani, A., (2009), Ndhima juridike pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, fq. 11.

<sup>15</sup>Jacobs, M., (2008), Familien in Trennung und Scheidung, Ministerium für Familie und Integration, Fq. 42.

<sup>16</sup>Omari, S., (2012), E drejta Familjare, Tiranë, fq. 225.

### 3 USHTRIMI I SË DREJTËS PRINDËRORE

#### 3.1. Prindëria pas shkurorëzimit të martesës në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Gjatë përcaktimit të nocionit të së drejtës prindërore duhet të kemi parasysh kuptimin e dyfishtë të kësaj. E drejta prindërore paraqet pjesë të së drejtës familjare e cila merret me rregullimin e marrëdhënieve të prindërve dhe fëmijëve si dhe rregullimin e marrëdhënieve të kategorive tjera të familjarëve. Përkrahë rregullimit të marrëdhënieve juridike, para së gjithash në mes të prindërve dhe fëmijëve, në mas më të vogël edhe në mes familjarëve tjerë, e drejta prindërore merret edhe me studimin e atyre marrëdhënieve dhe prej ku edhe dalin dy kuptimet e saj:

- a. E drejta prindërore si pjesë e sistemit juridik të një shteti.
- b. E drejta prindërore si pjesë e shkencës juridike e cila i studijon marrëdhëniet juridiko-prindërore.<sup>17</sup>

Të drejtat prindërore prindërit i ushtrojnë së bashku me marreveshje. Në rast të mosmarreveshjes nga ana e prindërve për ushtrimin e së drejtës prindërore vendos Qendra për Punë Sociale.<sup>18</sup>

Ushtrimi i së drejtës prindërore nënkupton që prindërit ta realizojnë përmbajtjen e kësaj të drejte, përmbajtjen e të drejtave dhe detyrimeve të cilat janë të përshkruara në lidhje me fëmijët e mitur të tyre, përkatësisht fëmijëve që u është vazhduar e drejta prindërore.

Nëpërmejt përshkrimit se prindërit e ushtrojnë të drejtën prindërore bashkarisht dhe me marreveshje, është shprehur barazia e burrit dhe gruas për rregullimin e marrëdhënieve prindërore, përkatësisht të nënës dhe babait ndaj fëmijëve të tyre.

<sup>17</sup> Trpenovska, S.L., (2004), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 145.

<sup>18</sup> Çavdar, K., Siljanoska-Kostadinovska, C., (2013), *Закон за семејството коментари, судска практика, предметен регистар за практична примена, придружни прописи и литература*, Sv.Kliment Ohridski, Skopje, fq. 203.

Me ushtrimin e së drejtës prindërore mënjëherë sigurohet mbrojtja juridiko-familjare e fëmijëve të mitur të parapara me Kushtetutë dhe me ligj.

Sipas Ligjit për familje, prindërit e ushtrojnë të drejtën prindërore bashkarisht dhe me marrëveshje edhe atëherë kur prindërit nuk jetojnë bashkërisht por për disa arsye fëmija ndodhet në mbajtje dhe edukim te njëri prej tyre.<sup>19</sup>

E drejta prindërore u takon nënës dhe babait në mënyrë të barabartë. Nëse njëri prej prindërve është i vdekur ose i panjohur ose i është marrë e drejta prindërore ose nga arsye tjera është penguar të ushtrojë të drejtën prindërore, atëherë të drejtën prindërore e ushtron prindi tjetër.<sup>20</sup>

Përkatësisht në bazë së dispozitës së nenit 78, në atë rast merren vesh vetëm për atë se te cili prej tyre do të qëndrojë fëmija për ruajtje dhe edukim. Nëse për atë nuk pajtohen, vendos organi kompetent (Qendra për Punë Sociale, - neni 78 ose Gjykata në bazë të nenit 80, 81), pra në bazë të asaj dispozite nuk nënkupton se vetëm njeri prind e ushtron të drejtën prindërore.

E drejta e fëmijeve që të jetojnë me prindërit e tyre ka rëndësi të madhe për shkak se Konventa për të Drejtat e Fëmijës e ndalon ndarjen e fëmijës nga prindërit në kundërshtim me vullnetin e tyre. Në atë drejtim ndarja e fëmijëve nga prindërit është e lejuar vetëm atëherë kur ajo është e domosdoshme dhe është në interes të fëmijës, me vendim të organit kompetent me procedurë të parapara ligjore. Në këtë drejtim, Ligji për familje parasheh se nëse atë e kërkon interesi i fëmijës, prindërit mundet t'ia besojnë fëmijën në ruajtje dhe edukim personit të tretë ose ta vendosin në institut kompetent (Neni 77, paragrafi 1).

Nëse prindërit ose prindi i cili vetë e ushton të drejtën prindërore për shkaqe të arsyshme në kohë me të gjatë mungon nga vendbanimi dhe me vete nuk i merr fëmijët, fëmijët mundet t'ia besojnë në ruajtje dhe edukim personit tjetër përderisa Qendra për Punë Sociale

---

<sup>19</sup>Çavdar, K., Siljanoska-Kostadinovska, C., (2013), *Zakon za семејството коментари, судска практика, предметен регистар за практична примена, придружни прописи и литература*, Sv.Kliment Ohridski, Skopje, fq. 203.

<sup>20</sup>Neni 45, paragrafi 1 dhe 2, Ligji për Familje.

paraprakisht jep pëlqim për një vendim të tillë. Llogaritet se pëlqimi është i dhënë në rast se në afat prej 3- ditësh pas parashtrimit të kërkesës Qendra për Punë Sociale nuk sjell vendim. Fëmija nuk mund t'i jepet në ruajtje dhe edukim personit i cili nuk mund të jetë kujdestar.<sup>21</sup>

Një nga pyetjet mërelevante e cila parashtrohet në rastet kur prindërit nuk jetojnë së bashku është e drejta e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontaktet direkte me fëmijen.

Në rastet kur prindërit e fëmijes nuk jetojnë së bashku atëherë ata merren vesht për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale dhe kontaktet direkte me fëmijën. Në rast se prindërit e fëmijes në afat prej më së shumti dy muaj nuk dakordohen për mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte për fëmijet, në atë rast sjell vendim Qendra për Punë Sociale.

Gjatë përcaktimit të marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte mes fëmijës dhe prindit Qendra për Punë Sociale e informon fëmijën dhe i merr parasysh qëndimet dhe mendimet e tij varësisht nga mosha dhe shakalla e zhvillimit të tij, gjithashtu e informon për pasojat e mundshme nga vendimet. Qendra për Punë Sociale me kërkesë të prindërit mundet përsëri ta rregullojë mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte të fëmijës me prindërit nëse atë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara.

Mbajtja e marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte të fëmijës me prindërit mund të kufizohet ose përkohësisht të ndalohet vetëm për shkak të mbrojtjes së shëndetit dhe interesave tjera të fëmijës.<sup>22</sup>

Në rast të shkurorëzimit, Ligji për familjen përcakton se me aktvendimin e shkurorëzimit gjykata vendos dhe për ruajtjen, edukimin dhe mirëmbajten e fëmijëve tëpërbashkët. Në rast se prindërit nuk janë dakorduar për atë ose marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijës, gjyqi, pasi të sigurojë mendim prej Qendrës për Punë Sociale dhe t'i shqyrtojë të gjithë rrethanat, do të vendosë nëse fëmijët do të mbesin në ruajtje dhe edukim te njëri prind ose

---

<sup>21</sup>Trpenovska, S. L., Micković, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 200.

<sup>22</sup>Neni 79, Ligji për familje.

disa do të mbesin te nëna e disa te babai ose të gjithë do t'i besohen një personi të tretë ose institucionit përkatës shtetëror.<sup>23</sup>

Nëse gjyqi nuk ka përcaktuar ndryshe duke pas parasysh interesat e fëmijëve, prindëri të cilit nuk i janë besuar fëmijët ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte direkte me ata.

### **3.2. Mbikqyrja mbi ushtrimin e së drejtës prindërore**

Mbikqyrja mbi ushtrimin e së drejtës prindërore, në thelb paraqet marrëdhënie normativo-juridike me të cilën vendoset kontroll në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore, varësisht prej njohurive të caktuara të ndërmerren masa për mbrojtjen të personalitetit të fëmijës, mbrojtjes të të drejtave dhe interesave të tij. Në fakt ajo është mjet juridik për realizimin e të drejtave të fëmijëve në lidhje me prindërit, thënë në përgjithësi në formën e tij parësore si intervenim potencial por në fund të fundit edhe masa ndëshkuese, (marrja e fëmijës, propozim për marrjen e ushtrimit të së drejtës prindërore).<sup>24</sup>

Realizimi i së drejtës prindërore nuk është vetëm në interes të fëmijës dhe prindërve, por edhe në interes më të gjërë shoqëror. Në atë drejtim për dallim nga ligdhënësit tjerë, në të drejtën tonë familjare, roli i Qendrës për Punë Sociale ka rëndësi të madhe në realizimin e mbikqyrjes mbi ushtrimin e të drejtës prindërore. Qendra për Punë Sociale është e detyruar të ndërmarrë masat e duhura për mbrojtje të personalitetit, të të drejtave dhe interesave të fëmijës. Për këtë arsye, secili qytetar dhe person juridik është i detyruar ta informojë Qendrën për Punë Sociale menjëherë pasi të kuptojë se prindi nuk e ushtron të drejtën prindërore ose nga arsye të tjera është e nevojshme mbrojtja e personalitetit, të të drejtave dhe interesave të fëmijës. Roli aktiv i Qendrës veçanërisht vjen në shprehje kur vjinë në pyetje interesat e fëmijës. Në atë kuptim Qendra për Punë Sociale i paralajmëron prindërit për mungesat në

---

<sup>23</sup>Trpenovska, S. L., Micković, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 202.

<sup>24</sup>Çavdar, K., Siljanoska-Kostadinovska, C., (2013), *Закон за семејството коментари, судска практика, предметен регистар за практична примена, придружни прописи и литература*, Sv. Kliment Ohridski, Skopje, fq. 230.



edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe u ndihmon që fëmijët në mënyrë të drejtë të edukohen dhe zhvillohen.<sup>25</sup>

Mbikqyrja që ushtron Qendra për Punë Sociale mund të transformohet edhe në mbikqyrje të përhershme mbi ushtrimin e së drejtës prindërore nëse Qendra për Punë Sociale duke e vlerësuar situatën sjell vendim për atë. Mbikqyrja e përhershme mund ti përfshijë të gjithë fëmijët ose ndonjë prej tyre.<sup>26</sup>

### **3.3. Pushimi dhe vazhdimi i së drejtave prindërore**

#### **3.3.1. Pushimi i së drejtës prindërore**

Marrëdhënia prindërore e krijuar me lindje në mes të prindërve dhe fëmijëve është me karakter të përhershëm dhe kjo nuk mund të ndërpritet. Për dallim nga ajo të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia prindërore nuk janë me karakter të përhershëm. Ata janë të lidhura me nevojat dhe interesat e fëmijëve. Si rezultat i saj e drejta prindërore ndërpritet në këto raste të parapara me ligj:

1. Në moshën madhore;
2. Me lidhjen e martesës së fëmijës para se të mbushë moshën madhore;
3. Me vdekjen e prindërve ose fëmijës.

Në moshën madhore, gjegjësisht me mbushjen e moshës 18 vjeçare fëmija fiton zotësi veprimi dhe mundet vetë të kujdeset për të drejtat dhe interesat personale. Ai fiton pjekuri fizike dhe psikike vetvetiu të kujdeset për veten, për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave personale.

Në mbushjen e moshës 16 vjeçare i mituri mund të lidhë martesë me leje të gjyqit. Gjykata me procedurë jokontestimore do të lejojë lidhje të martesës të të miturit nëse vërteton se ai ka arritur pjekuri psikike të duhur për kryerjen e të drejtave dhe detyrave që rrjedhin nga martesa. Me lidhjen e martesës i mituri fiton zotësinë e veprimit. Nëse martesa e personit të mitur ndërpritet para se ai të mbush 18 vjet nuk ka ndikim te zotësia e veprimit. Si rezultat i

---

<sup>25</sup>Trpenovska, S. L., Mickoviq, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 213.

<sup>26</sup>Trpenovska, S. L., (2004), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 164.

kësaj e drejta prindërore është ndërprerë për shkak se personi i mitur ka lidhur martesë në dhe rast të ndarjes nuk mund ti rikthehet.

Me vdekjen si fakt natyror shuhen të drejtat dhe detyrimet personale të personit fizik. Në atë kuptim, me vdekjen e njërit ose të dy prindërve ose me vdekjen e fëmijës ndërpritet e drejta prindërore si e drejtë personale sepse pushon së ekzistuari personaliteti në interes të të cilit ka qenë e paraparë.<sup>27</sup>

### **3.3.2. Vazhdimi i së drejtës prindërore**

Ashtu sikurse tepushimi i së drejtës prindërore që parakusht ishte pjekuria fizike dhe psiqike e personit të mitur dhe aftësia e tij për tu kujdesur për vete dhe për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tij, ashtu edhe mungesa gjegjësisht, mangësitë në zhvillimin fizik dhe psiqik të fëmijës mund sjellin deri te vazhdimi i të drejtës prindërore edhe pas arritjes së moshës madhore.<sup>28</sup>

Për vazhdimin e së drejtës prindërore kompetent është gjyqi i cili vendos në procedurë jokontestimore. Sipas Ligjit mbi familje, propozim deri te gjyqi mund të parashtrojnë prindërit ose Qendra për Punë Sociale. Gjyqi vendos në bazë të fakteve me të cilat vërteton se personi nuk është psiqikisht i aftë të kujdeset për personalitetin, të drejtat dhe interesat e tij.<sup>29</sup>

Kur të pushojnë shkaqet nga të cilat e drejta prindërore është vazhduar, gjyqi me propozim të prindërve ose Qendrës për Punë Sociale do të vendosë për ndërprerje të së drejtës prindërore. Vendimi i gjyqit për vazhdim të së drejtës prindërore dhe vendimi për ndërprerje të së drejtës prindërore regjistrohet në Librin Amë të të Lindurve dhe libra për evidencë të patundshmërive.<sup>30</sup>

---

<sup>27</sup>Trpenovska, S. L., Micković, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 216, 217.

<sup>28</sup>Trpenovska, S. L., (2004), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 168.

<sup>29</sup>Trpenovska, S. L., Micković, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 217

<sup>30</sup>Çavdar, K., Siljanoska-Kostadinovska, C., (2013), *Закон за семејството коментари, судска практика, предметен регистар за практична примена, придружни прописи и литература*, Sv. Kliment Ohridski, Skopje, fq. 243, 244.

## **4. DOUMENTET NDËRKOMBTAJE QË GARANTOJNË PRINDËRINË E PËRBASHKËT**

### **4.1. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës**

Një nga dokumentet ndërkombtare që ka ndikim të madh në legjislacionet dhe ndikim direkt në të drejtat e fëmijëve është Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve. Karakteristikë e veçantë e kësaj konvente është trajtimi i fëmijëve si subjekt i veçantë, krijesë autonome që ka të drejta të patjetërsueshme.<sup>31</sup>

Shtetet palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës. (Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, neni 18 al. 1).

### **4.2. Charter of fundamental rights of the EU – Karta e të Drejtave**

#### **Themelore të BE-së**

Të drejtat e fëmijës

1. Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje dhe kujdes të tillë siç është e nevojshme për mirëqenien e tyre dhe mund të shprehin lirisht pikëpamjet e tyre. Pikëpamjet e tilla do të merren në konsideratë për çështjet që kanë të bëjnë në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre.

2. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, qoftë të ndërmarra nga autoritetet publike ose institucionet private, interesat më të mirë të fëmijëve duhet të jenë konsideratë parësore.

---

<sup>31</sup>Trpenovska, S. L., Mickoviq, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje, fq. 186.

3. Çdo fëmijë ka të drejtë të mbajë rregullisht një marrëdhënie personale dhe të drejtpërdrejtë kontakti me prindërit e tij ose të saj, përveç nëse kjo është në kundërshtim me interesat e tij ose të saj. (Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, neni 24, al.1, 2, 3)

#### **4.3. European Convention on the Exercise of children's rights – Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Konventa synon të mbrojë interesat në të mirë të fëmijëve. Kjo konventë siguron një numër masash procedurale për t'i lejuar fëmijët të ushtrojnë të drejtat e tyre. Konventa parashikon masa që synojnë promovimin e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht në procedurat familjare para autoriteteve gjyqësore. Autoriteti gjyqësor, ose personi i caktuar për të vepruar para një autoriteti gjyqësor në emër të një fëmije, ka një numër detyrash të krijuara për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave nga fëmijët. Fëmijëve duhet të lejohen t'u ushtrojnë të drejtat e tyre (për shembull: e drejta për t'u informuar dhe e drejta për t'i shprehur pikëpamjet e tyre) vetë ose përmes personave apo organeve të tjera. Në llojet e procedurave familjare me interes të veçantë për fëmijët janë ato që kanë të bëjnë me kujdestarinë, vendbanimin, hyrjen, çështjet e prindërve, legjitimitetin, birësimin, kujdestarinë ligjore, administrimin e pasurisë së fëmijëve, procedurat e kujdesit, heqjen ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore, mbrojtjen nga mizoria ose trajtimi degradues dhe trajtimi mjekësor.<sup>32</sup>

#### **4.4. Convention on contact concerning children – Konventa për Kontaktin në Lidhje me Fëmijët**

Duke pasur parasysh problemet e natyrshme në ushtrimin dhe mbrojtjen e marrëdhënieve personale të fëmijëve, si dhe kufizimet e mundshme të saj, Konventa synon të rregullojë këto marrëdhënie në dritën e interesave më të mira të fëmijës. Qëllimi i Konventës është të përmirësojë disa aspekte të së drejtës së kontaktit kombëtar dhe ndërkufitar, veçanërisht, të specifikojë dhe të forcojë të drejtën themelore të fëmijëve dhe prindërve të tyre për të mbajtur kontakte rregullisht.<sup>33</sup>

---

<sup>32</sup><https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/160> (14.06.2020)

<sup>33</sup><https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/192> 14.06.2020)

## 4 MODELET E NDRYSHME TË PRINDËRISË PAS SHKURORËZIMIT

### 4.1. Koncepti i „Joint legal custody” dhe „Joint physical custody” pas shkurorëzimit të martesës

Me nocionin prindëri të përbashkët nënkuptojmë kur prindërit pas shkurorëzimit marrin përgjegjësinë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijës së tyre, praktikdestaria e fëmijëve u shkon automatikisht të dy prindërve dhe asnjë vendim i rëndësishëm për të ardhmen e një fëmijëvetë mos merret pa pëlqimin e të dy prindërve.<sup>34</sup>

Në fillim të vitetve 80-ta në shtetin e Kalifornisë u paraqitën ndryshime radikale në Ligjin për familje. Në vitin 1980 u miratua një ligj që zgjeroi gamën e rregullave ekzistuese të prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit. Shumë shtete ndoqën shembullin e Kalifornisë, duke lejuar parimin e prindërisë së përbashkët dhe duke e parashikuar atë si rregull.<sup>35</sup>

Nocioni „joint custody” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përjetoj nënndarje dhe diferencime të mëtutjeshme, të cilat trajtohen ndryshe dhe individualisht nëpër shtete të ndryshme. Nëse bëhet fjalë për „joint custody”, atëherë duhet dalluar, nëse bëhet fjalë për „prindëri të përbashkët ligjore/juridike” (joint legal custody) (prindërit bashkarisht janë përgjegjës për jetën e fëmijës), ose për „përkujdesje materiale të përbashkët” (joint physical custody), që faktikisht nënkupton prindëri të përbashkët (coparentig), (rregullimin e kontakteve me prindërin me të cilin nuk jeton fëmija parashihet me ligj).<sup>36</sup>

Koncepti „joint legal custody” nënkupton situatën kur të dy prindërit kanë autoritet ligjor të marrin vendime për fëmijën. Vendimet kryesore ligjore që mund të merren në lidhje me jetën e një fëmije përfshijnë: edukimin e tyre, shëndetin dhe kujdesin mjekësor, praktikën dhe besimet fetare, aktivitetet jashtëshkollore dhe shumë më tepër. Kusht kryesor është që

---

<sup>34</sup><https://www.babelli.de/gemeinsames-sorgerecht/> (14.06.2020) Konrad, P., (2019), Gemeinsames Sorgerecht beantragen: Das musst du wissen.

<sup>35</sup>Barth-Richtarz, J., (2011), Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedingungen der Kinder, Springer, Wien, fq. 27.

<sup>36</sup>Merkt, H., (1994), Kinderschaftsrecht im Wandel - Das Kinderschaftsrecht in den Vereinigten Staaten von Amerika, J.C.B Mohr (Paul Siebeck), Tübingen, fq. 465.

marrëveshja midis prindërve të jetë e drejtë dhe në çdo aspekt duhet të pajtohen të dy prindërit me këtë lloj kujdestarie.<sup>37</sup>

Me anë të konceptit „Joint physical custody”, fëmija jeton te njëri prindër, por të dy kanë të drejta të barabarta në marrjen e vendimeve në lidhje me mirëqenien, edukimin, kujdesin shëndetësor dhe fenë e fëmijës. Prindërit duhet t’i kushtojnë fëmijës një pjesë të caktuar të kohës së tyre. Rregullimi i kontaktit me prindin me të cilin nuk jeton fëmija përcaktohet me ligj. Ligji parasheh kohën për kontakt, në të cilin vendosja e parimit 50-50 është në favor të fëmijës dhe të prindërve. Parimi 50-50 mund të zëvendësohet edhe me mënyra tjera, si për shembull: fëmija mund të vendosi, që në mes stinës së verës të jetojë me babanë dhe gjatë vitit shkollor me nënën. Prindërit që vendosin për kujdestari të përbashkët për fëmijët e tyre, shpeshherë kanë hapësirë më të gjerë në strukturimin e planeve të tyre si prindër.<sup>38</sup>

Fatkeqësisht, nuk ka ende një përcaktim të saktë të „Joint physical custody” dhe ky është një debat i vazhdueshëm i shkencëtarëve, praktikuesve, politikëbërësve dhe të tjerëve rreth asaj se sa kohë me secilin prind do të kërkohej të jetojë fëmija për t’u përmbushur kriteri i „përkujdesjes së përbashkët”.<sup>39</sup>

Sipas rezultateve të ndryshme të studimeve empirike tregohet, se prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit ka një ndikim neutral ndaj pozitivitetit të fëmijës në mirëqenien e tyre.

„Joint psysicial custody” mundëson tejkalimin e problemeve dhe vështirësive lidhur me shkurorëzimin e prindërve dhe gjithashtu mundëson që fëmijët të kenë zhvillim psikosocial që nuk do të dallonshin nga fëmijët që rriten në bashkësi familjare me të dy prindërit. Gjithashtu,

---

<sup>37</sup> J, Barth-Richtarz, (2011), Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedinungen der Kinder, Springer, Wien, fq. 28.

<sup>38</sup> J, Barth-Richtarz, (2011), Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedinungen der Kinder, Springer, Wien, fq. 29.

<sup>39</sup> Steinbach, A., Family process, Children’s and Parents’ Well-Being in Joint Physical Custody: A Literature Review, fq.3.

ka ndikim pozitiv në zhvillimin psikologjik të fëmijës pas shkurorëzimit. Si anë negative të „Joint psysicial custody” na paraqitet ndyshimi i shpeshtë i vendbanimit të fëmijës.<sup>40</sup>

#### **4.2. Efekti i „Joint Physical Custody” te prindërit**

„Joint Physical Custody” përveç ndikimeve të ndryshme që tregon te fëmijët, ky model jep efekte edhe te prindërit e shkurorëzuar. Së pari, prinderit e shkurorëzuar në përgjithësi e kanë më të predispozuar se të tjerët të pësojnë keqtrajtime në fusha të ndryshme të jetës që mund të ndikojë drejtëpërdrejt edhe te fëmijët pra, mirëqenia e prindërve ka një ndikim të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë në mirëqenien e fëmijës.

Ka disa argumente kontradiktore se prindëria e përbashkët nuk ndikon vetëm te fëmijët, por ekziston mundësia që ajo të ndikojë edhe te prindërit. Konfliktet prindërore mund të reduktohen në mënyrë të konsiderueshme nëse ekziston marrëveshja rreth prindëris së përbashkët sepse nënat dhe baballarët marrin status të barabartë në lidhje me të drejtat dhe detyrat e tyre prindërore.

Një argument tjetër është se me anë të „Joint physical custody” prindërit kanë burime më të mira financiare, shëndet më të mirë, liri më të madhe dhe ulja e ngarkesës së përgjithshme të prindërve dhe stresit. Sidoqoftë, „Joint physical custody” mund të jetë shumë stresuese sepse prindërit duhet të planifikojnë dhe koordinojnë vazhdimisht detyrat e kujdesit për fëmijët.<sup>41</sup>

#### **4.3. Efekti i „Joint Custody” në mirëqenien e fëmijës**

Koncepti i „joint custody” ndikon në mirëqenien e fëmijës pasi mundëson që fëmijët të kenë kontakt të vazhdueshëm me të dy prindërit.

Fëmijëve u jepet mundësia për të pasur dy shtëpi në të njejtën kohë. Modeli i tillë te fëmijët rritë ndjenjën e dashurisë nga të dy prindërit, gjë që mund të rrisë vetëbesimin te fëmijët. Fëmijët që rriten me modelin „joint custody” kanë ndjeshëm më pak probleme emocionale dhe sjellje më pozitive dhe fëmijët e tillë mund të kenë arritje më të larta arsimore.

---

<sup>40</sup>Selmani, A., (2018), E drejta Familjare Bashkëkohore, ligjerata 4.

<sup>41</sup> Steinbach, A., (2018), Children’s and Parent’s well-being in joint physical custody: A literature review, fq. 9-10.

Megjithatë, ekziston mundësia që fëmija të ndjehet i mbingarkuar dhe i hutuar, që shpesh mund të ndikojë edhe te mirëqenia psikik e fëmijes duke shkaktuar pakënaqësi por dhe depresione.

Komponenta më thelbësore dhe më e dobishme e „joint custody” për fëmijën qëndron në: qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e prindërve. Marrëdhëniet bashkëpunuese dhe të respektitmes prindërve dhe fëmijëve luajnë rëndësi të madhe për përshtatjen e fëmijëve me rrethanat e reja. Kështu që, një fëmijë i cili rritet, zhvillohet dhe përkujdeset nga të dy prindërit ka aftësinë që të përshtatet shumë më shpejtë në rrethana të reja sesa një fëmijë që ka përkujdesjen vetëm nga njëri prind.

Megjithatë „joint custody” nuk është zgjidhje dhe model i përshtashëm për të gjithë prindërit, ndaj dhe nuk mund të vendoset a bëhet fjalë për një formë pozitive apo negative të prindërisë.<sup>42</sup>

---

<sup>42</sup>J, Barth-Richtarz, (2011), Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedingungen der Kinder, Springer, Wien, fq. 41.



## **5 NDIKIMI I SHKURORËZIMIT TE FËMIJËT**

### **5.1. Mirëqenia e fëmijës dhe prindëria e përbashkët**

Shkurorëzimi i prindërve prek fëmijët në mënyrë të veçantë, në vend të kontakteve të përditshme, joformale të cilat mundësojnë një shkëmbim spontan të ideve, krijohet një orar fiks për përkujdesje të fëmijëve.<sup>43</sup>

Procedura e shkurorëzimit paraqet një barrë për gjithë familjarët, gjatë kësaj periudhe duhet të merren shumë vendime si: cila formë e rregullimit të kujdestarisë konsiderohet si më e përshtatshme, pastaj duhet të vendoset se ku do jetojë fëmija në të ardhmen, cili prindër është më i përshtatshëm për mirëqenien e fëmijës dhe kush ka të drejtën ta vizitojë fëmijën dhe në çfarë kushtesh.<sup>44</sup>

#### **5.1.1. Mirëqenia e fëmijës**

Në veçanti për mirëqenien e fëmijës, përveç nevojave themelore, përmendet edhe stabiliteti i marrëdhënieve mes fëmijës dhe prindërve. Përveç plotësimit të nevojave themelore fizike, si: ushqimi, kujdesi, ngrohtësia, higjena dhe kujdesi mjekësor paraqiten edhe nevoja për shoqërim, nevoja për dashuri, afërsi si dhe pranim. Këto nevoja mund të zgjojnë reagime dhe sinjale të ndjeshme te fëmijët. Për më tepër, fëmijët kanë nevojë për sigurimin e një mjedisi të menaxhueshëm dhe të njohur jetësorë.<sup>45</sup>

Ekzistojnë një mori faktorësh që ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve pas shkurorëzimit, përfshirë edhe konfliktin prindëror si para ashtu dhe pas ndarjes, rregullimin e marrëdhënieve të prindërve gjatë shkurorëzimit dhe shkallën e afërsisë midis fëmijëve dhe prindërve. Gjithashtu, ka shumë faktorët që lidhen me personalitetin e fëmijëve, gjininë dhe moshën e tyre, funksionimin para dhe pas shkurorëzimit dhe praktikat e prindërisë së përbashkët, rrethanat socio-ekonomike në të cilat fëmijët e gjejnë veten pas shpërbërjes martesore, faktorë këto që ndikojnë në aftësinë e fëmijëve për t'u përshtatur me situatën e tyre të re.

<sup>43</sup>Trachsel, D., (2012), Scheidung – Faire Regelung für Kinder, Wohnung und Finanzen, 16., überarbeitete und aktuelle Auflage, Beobachter, Zürich, fq.16.

<sup>44</sup>Simmerer, Th., (2005), Einflussfaktoren bei der Bewertung des gemeinsamen Sorgerechts, Wien, fq. 5.

<sup>45</sup>Simmerer, Th., (2005), Einflussfaktoren bei der Bewertung des gemeinsamen Sorgerechts, Wien, fq. 5.

Mirëqenia e fëmijës paraqet një maksimum kryesor. Fëmijët dhe adoleshentët botën e perceptojnë më ndryshe ndaj prindërit e shkurorëzuar duhet t'i dëshmojnë fëmijës se e duan dhe se kujdesen për atë. Fëmijët që ndjehen se janë të dashur, kanë më shumë vetëbesim. Prindërit gjithmonë duhet të paraqesin dhe t'u japin fëmijëve të tyre shembull të mirë, pasi fëmijët e imitojnë atë që shohin dhe ndëgjojnë nga të tjerët.<sup>46</sup>

Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

Prindëria e përbashkët është e garantuar gati me të gjitha dokumentet ndërkombëtare të cilët kanë për qëllim respektimin e interesit më të lartë të fëmijës, ndër ta më e rëndësishme është Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe për këtë qëllim ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse. Shtetet palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.<sup>47</sup>

Shtetet palë garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse se kjo ndarje është e domosdoshme në interes më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si: kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija. (Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, neni 9 al. 1)

---

<sup>46</sup>Trachsel, D., (2012), Scheidung – Faire Regelung für Kinder, Wohnung und Finanzen, 16., überarbeitete und aktuelle Auflage, Beobachter, Zürich, fq.16.

<sup>47</sup>Neni 4, Konventa e OKS-së mbi të drejtat e fëmijës.

Shtetet palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës. (Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, neni 9 al. 3).

Shtetet palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës. (Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, neni 18 al. 1).

## **5.2. Marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit**

Ndarja e prindërve pothuajse gjithmonë nënkupton reduktim apo ulje të kohës që fëmijakalon me prindin e ndarë, por ka edhe raste kur fëmija vetëm një herë në vit ose aspak nuk ka kontakte me prindin e ndarë. Hulumtimet tregojnë se frekuenca e kontakteve ose marrëdhëniet gjithnjë e më tepër ulen dhe zbehen, gjë që për fëmijët nuk paraqet aspak shenjë pozitive.<sup>48</sup>

Me ndarjen e prindërve nuk ndryshojnë vetëm marrëdhëniet me prindin me të cilin nuk jeton fëmija, por edhe marrëdhëniet me prindin me të cilin jeton. Në periudhën pas shkurorëzimit përveç fëmijës edhe prindi me të cilin jeton fëmija është në qendër të konflikteve emocionale, por jo për arsye se ky prind është përgjegjës për kujdesin ndaj fëmijës, por për shkak se dhe vetë gjendja fizike dhe psikologjike e prindërit ndryshon.<sup>49</sup>

Fëmijët që jetojnë me nënën e tyre pas shkurorëzimit jo vetëm që humbasin sasi të konsiderueshme të kohës së kaluar me babain e tyre, por edhe me nënën, kështu që fëmija mund të pësojë humbje të dyfishtë të dashurisë dhe marrëdhënieve prindore. Shumë shpesh pas shkurorëzimit, marrëdhëniet mes fëmijës dhe prindërit me të cilin jeton fëmija përkeqësohen dhe te fëmija lindin ndjenjat e ofendimit, frika nga e ardhmja, ndjenjat e zemërimit dhe

---

<sup>48</sup>J, Barth-Richtarz, (2011), Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedingungen der Kinder, Springer, Wien, fq. 143-144.

urrejtjes, trishtim, ndjenja e fajit, ndjenja e dështimit por dhe probleme të llojit social. Përveç fëmijët që ballafaqohen me probleme emocionale, me probleme të natyrës së njejtë, si: barrë profesionale dhe familjare, ndjenja të reja specifike të rikrijuara për fëmijën si: ndjenjë faji, fyerje, agresivitet ndaj fëmijës çojnë drejtë zmadhimit të konflikteve të marrëdhënieve.<sup>50</sup>

Faktorët e lartëpërmendur paraqesin pasojat e mëposhtme për qëndrimetose ndryshimet në sjelljen e prindit që kujdeset për fëmijën:

- Nivel të ulët të empatisë;
- Nivel të ulët të tolerancës ndaj nevojave të fëmijës;
- Rritje e kërkesave të bëra ndaj fëmijës, veçanërisht në lidhje me përshtatjen dhe pavarësinë e tij;
- Pasiguri, dobësi dhe ndyshime të disponimit dhe humorit, që fëmijës i japin ndjenjën e pasigurisë (në shumicën e rasteve ndodh që fëmija dhe prindi të ndryshojnë rolet e tyre);
- Frika dhe pafuqia ndaj reagimeve të fëmijës;
- Përkujdesje dhe koncentrim i më tepërt ndaj fëmijëve më të vegjël;

Ndryshimet në marrëdhënie mes fëmijës dhe prindërit qëkujdeset për atë, nuk mund të ndihmohin vetëm nga ana e prindit, por mund të vijë edhe direkt nga vetë fëmija. Duke ditur shprehjen se dashuria nuk zgjat përgjithmonë, ata mendojnë se dhe dashuria e prindërve mund të mos u garantohet atyre, ndaj dhe fëmija shkon drejt një lëkundjeje midis agresionit dhe ankthit të ndarjes që konfirmohet fatalisht nga ndryshimet e sjelljes reale të prindit. Marrëdhënia e fëmijës me prindin me të cilin jeton kryesisht mund të ketë pasojë sidomos për mënyrën sesi fëmija mund të përballojë përvojën e shkurorëzimit.<sup>51</sup>

Për të përballuar situata të tilla rekomandohet të merret ndihmë profesionale. Ndihamat nga personat profesional si dhe këshillat kompetente rrit mundësinë e korrigjimit të shpejtë të vendimeve të marra gabimisht, me qëllim që fëmijët të kthehen në rrugën e drejtë të zhvillimit.

---

<sup>50</sup>J, Barth-Richtarz, (2011), Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedingungen der Kinder, Springer, Wien, fq. 153.

Ndihma profesionale do të ndihmojë fëmijën por edhe prindin. Fëmija duhet të mbajë marrëdhënie të fortë dhe ta ruajë dashurinë për prindin tjetër, sepse mbështetja e të dy prindërve është gjëja më e mirë dhe më e shëndetshme dhe rruga më e mirë që fëmija ta pranojë divorcin e prindërve pa pasoja të rënda.<sup>52</sup>

### **5.3. Ndikimi i shkurorëzimit të sjellja e fëmijëve**

Shkurorëzimiparaqet një humbje të madhe të paktën për njërin bashkëshort dhe i shkakton atij disfiksione personale që shprehen në depresion dhe agresion jashtë normave. Disfiksioni mund të ndikojë në përgjegjësinë prindërore e cila mund të shkatërrohet. Shkurorëzimi përbëhet nga një cikël zhvillimesh të cilat shpesh sjellin konsekuenca të rënda për prindërit dhe fëmijët.

Shkurorëzimi i prindërve është stresues për fëmijët. Fëmijët janë shumë të mërëzitur në momentet fillestare të shkurorëzimit. Kur shohin se çfarë ka ndodhur në fëmijërinë e tyre, shumë adoleshentë e përshkruajnë periudhën fillestare ose menjëherë pas shkurorëzimit të prindërve të tyre si momentin më të dhimbshëm të jetës së tyre. Në këtë periudhë ka fëmijë që aspak nuk kuptojnë se çfarë është duke ndodhur. Fillimisht këta fëmijë janë të shokuar nga ndarja e prindërve. Krahas kësaj gjëndje të fëmijët dallohen sjelljet e të kundërshtuarit, e tensionit dhe e pakënaqësisë.

Për të kuptuar në mënyrë sa më të plotë reagimet afatëshkurtra të fëmijëve duhet të analizohet fakti se si impakti i divorcit ndryshon midis djemve dhe vajzave dhe në përgjithësi të fëmijët e moshave të ndryshme.<sup>53</sup>

Shkurorëzimi gjithashtu, mund të ndikojë në marrëdhëniet duke çuar në humbjen e kontaktit me njërin prind, krijon vështirësi ekonomike dhe rrit nivelin e konfliktit midis prindërve. Për gjithë këto arsye, fëmijët përjetojnë një periudhë të vështirë gjatë tranzicionit të divorcit. Konflikti në familje lind shpesh kur prindërit fillojnë të ngrenë debate para fëmijëve,

---

<sup>52</sup>J, Barth-Richtarz, (2011), Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedingungen der Kinder, Springer, Wien, fq. 163.

<sup>53</sup>Trachsel, D., (2012), Scheidung – Faire Regelung für Kinder, Wohnung und Finanzen, 16., überarbeitete und aktuelle Auflage, Beobachter, Zürich, fq. 39.

gjendjen ekonomike dhe problemet e tyre personale. Lidhjet midis prindërve dhe fëmijëve fillojnë të kërcënohen menjëherë sapo njëri prind largohet nga familja.

Hulumtimet afatgjata tregojnë se kalimi nga martesë në shkurorëzim së pari shoqërohet me stres, depresion, ankth dhe çorganizim të situatës familjare e cila quhet ndryshe “kujdes minimal prindëror”.<sup>54</sup>

Njëkohësisht kjo periudhë kalimtare nga martesë në shkurorëzim shoqërohet edhe me çrregullime në procesin e të ushqyerit, të fjeturit si edhe në lidhjet që ekzistojnë midis prindërve dhe aktiviteteve të fëmijëve. Në këtë rast fëmijët reagojnë me distres dhe zemërim ndaj humbje së siguri së të jetuarit në shtëpi, ndërkohë që disiplina e tyre mund të bëhet e ashpër dhe e paqëndrueshme.

Duke parë në këndvështrimin e këtyre ndryshimeve është e kuptueshme se fëmijët përjetojnë reagime emocionale të dhimbshme. Ndarja e prindërve mund të rrisë nivelin e rrishtit që fëmijët të vuajnë nga probleme psikologjike dhe të sjelljes. Fëmijët në vështirësi të tilla janë veçanërisht të prirur të kenë probleme me agresivitetin, mosbindjen dhe thyerjen e ligjeve. Arritjet në shkollë janë të dobëta. Fëmijë të tjerë mund të përjetojnë shqetësim për një periudhë më të gjatë kohe. Por intensiteti i këtyre ndjenjave dhe mënyra sesi fëmijët e shprehin ndryshon në varësi të moshës, temperamentit dhe gjinisë. Në mënyrë të veçantë faktorët më të rëndësishëm që përcaktojnë efektin afatgjatë të divorcit janë dy: Faktori i parë është sesa të ekspozuar janë fëmijët ndaj konfliktit të prindërve dhe faktori i dytë është cilësia e prindërimit. Fëmijët reagojnë ndaj shkurorëzimit ndryshe në moshë të ndryshme. Pjesa më e madhe e fëmijëve shfaqin shenja të përmirësimit dhe të përshtatjes dy vjet pas ndarjes.<sup>55</sup>

Disa hulumtime tregojnë se fëmijët, që qëndrojnë në familje me konflikt të lartë kanë më tepër vështirësi përshtatshmërie sesa fëmijët që jetojnë në situata konfliktuale më të ulëta në familjet me një prind. Bazuar në këto studime lind pyetja: Mos vallë fëmijët përftojnë më

---

<sup>54</sup>Mali, A., (2014), Impakti i divorcit në çrregullimin e sjelljes së fëmijëve për grupmoshat 6-10 dhe 11-18 vjeç për rrethinën e Elbasanit, Tiranë, fq. 34. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/01/Doktoratura-Adriana-Mali-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Psikologji-Pedagogjiise.pdf> (10 Mai 2020).

shumë nga shkurorëzimi i prindërve? Përgjigja më e saktë në këtë rast do të ishte se: „shkurorëzimi paraqet më tepër mundësi ti dëmtoj fëmijët sesa t'i ndihmoj ata". Vetëm në ato raste kur prindërit e ndarë lenë menjatë mosmarrëveshjet dhe bashkarisht ndihmojnë në edukimin e fëmijës, fëmijët kanë mundësimë të mirë që të rriten më të gëzuar. Studiuesit gjithashtu theksojnë se pasojat e shkurorëzimit të fëmijët mbeten gjatë gjithë jetën.<sup>56</sup>

#### **5.4. Prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit sipas Legjislacionit**

##### **Gjerman**

Nëse prindërit jetojnë së bashku, nuk ka probleme në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për një fëmijë të mitur, por kur prindërit ndahen ose shkurorëzohen atëherë ndryshojnë shumë gjëra. Pyetja se me cilin prind duhet të jetojë fëmija në të ardhmen presupozon një shkallë të konsiderueshme të aftësive bashkëpunuese mes prindërve. Në shumicën e rasteve prindërit janë të gatshëm të përdorin edhe vetë fëmijën e tyre, të dëmtojnë partnerin/bashkëshortin, dhe të ndjekin qëllimet e veta. Që të mos vijë deri te konfliktet e lartpërmendura dhe të mos ndikojnë këto situata te fëmija, prindërit duhet të përpiqen të gjejnë zgjidhje reciproke të pranueshme për të dy palët. Kjo është mënyra e vetme për të ushtruar kujdestarinë në dobi të fëmijës pavarësisht ndarjes dhe shkurorëzimit

Sipas Legjislacionit Gjerman prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit krijohet kur asnjë nga prindit nuk aplikon për kujdestari të vetme (Neni 1671, Kodi Civil Gjerman, BGB).

Prindërit e ndarë që ndajnë kujdestari të përbashkët duhet të bien dakord për çështjet më të rëndësishme për fëmijën me marrëveshje të ndërsjelltë (Neni 1687, paragrafi 1, alinea 1, Kodi Civil Gjerman, BGB). Në të kundërt, çështjet e jetës së përditshme mund të vendosen nga prindi, p.sh. me cilin prind të jetojë fëmija pas ndarjes ose shkurorëzimit të prindërve. (Neni 1687, paragrafi 1, alinea 2, Kodi Civil Gjerman, BGB).

Pra, nëse ekziston kujdestaria e përbashkët pavarësisht ndarjes dhe shkurorëzimit, varet nga natyra e çështjes në fjalë nëse prindi kujdestar duhet të përfshihet në vendime apo jo.

---

<sup>56</sup>Trachsel, D., (2012), Scheidung – Faire Regelung für Kinder, Wohnung und Finanzen, 16., überarbeitete und aktuelle Auflage, Beobachter, Zürich, fq.40.

Çështjet e përditshme që paraqesin vendime të zakonshme nuk duhet të kenë efekte në zhvillimin e fëmijës (Neni 1687, paragrafi 1, alinea 3, Kodi Civil Gjerman, BGB). Koncepti autoritet i vetëm, në çështjet e jetës së përditshme interpretohet gjerësisht në mënyrë që prindi të marrë vendime dhe të veprojë sa më shumë të jetë e mundur në interes të mirëqenies së fëmijës.

Prindërit janë përgjegjës për ushtrimin e kujdestarisë prindërore marrëveshje të ndërsjellët për të mirën e fëmijës. Nëse ka dallime në shprehjen e mendimeve, ata duhet të përpiqen të bien dakord (Neni 1627, Kodi Civil Gjerman, BGB).

Prindëria e përbashkët edhe pas shkurorëzimit duhet të përqendrohet në atë që është më e rëndësishme dhe që është në interesin e fëmijëve. Fëmija nuk duhet të ndihet fajtor për zhvillimet pas divorcit, por duhet të jetojnë një jetë normale dhe të vëmendëshme nga të dy prindërit në mënyrë të barabartë. Shkurorëzimi duhet të shënojë përfundimin e martesës por jo edhe të qenët prind. Shumica e fëmijëve nuk dëshirojnë që prindërit e tyre të ndahen (përveç rasteve kur martesa ka qenë e mbushur me konflikte intensive, agresivitet, dhunë apo burime të tjera të këqija, të pa përshtatshme për fëmijët).

Nëse prindërit nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje që ka rëndësi të konsiderueshme për fëmijën edhe pas shkurorëzimit ose ndarjes, gjykata familjare mund ta transferojë vendimin e njërit prind te prindi tjetër. Transferimi mund të jetë subjekt i kufizimeve ose kushteve (Neni 1628, Kodi Civil Gjerman, BGB).

Nëse rrezikohet mirëqenia fizike, mendore, psikologjike si dhe mirëqenia pasurore kur prindërit (njëri apo të dy prindërit) janë të paaftë për të shmangur rrezikun, atëherë gjykata familjare mund të marri masa që do të jenë të nevojshme dhe të domosdoshme për shmangjen e rrezikut dhe për mirëqenien e fëmijës (Neni 1666, paragrafi 1, Kodi Civil Gjerman, BGB). Sipas këtij paragrafi, masat gjyqësore mund të përfshijnë:

- Sigurim për vijimin e detyrueshëm të shkollës;



- Ndalim të përkohëshëm për përdorimin e banesës ku qëndron fëmija si dhe qëndrimin në një zonë të caktuar larg banesës, ndalim në qëndrim në vende të përcaktuar (të njejta) ku është rregullisht fëmija;
- Ndalim për të komunikuar dhe për t'u takuar me fëmijën;
- Heqja ose marrja e pjesërisht ose e plotë e kujdestarisë prindërore.

Ndodh gjithashtu, kur njëri nga prindërit nuk mund të arrijë të realizojë ushtrimin e prindërisë vetëm në disa fusha të caktuara. Ai prind mund me vetëdëshirë të kërkojë nga gjykata familjare që t'i hiqet pjesërisht ose tërësisht ushtrimi i prindërisë së përbashkët (Neni 1671, Kodi Civil Gjerman, BGB).

## 6 METODOLOGJIA

Ky studim fokusohet në rëndësinë e zbatimit të prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit si një mekanizëm ligjor dhe social, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm fizik dhe psikik të fëmijëve që i përjetojnë ose i kanë përjetuar pasojat e shkurorëzimit të prindërve.

Në këtë pjesë të metodologjisë do të paraqiten elemente mjaft cilësore të studimit të tillë, si: formati i intervistës së përdorur, konsiderata etike, pjesëmarrësit e hulumtimit, metoda e mbledhjes së të dhënave, përfundimi i mbledhjes së të dhënave si dhe analiza e të dhënave.

### 6.1. Metodologjia e hulumtimit

Duke pasur parasysh qëllimin e studimit, për të kuptuar në thellësi realitetet personale të pjesëmarrësve në studim për prindërinë e përbashkët pas shkurorëzimit, nga perspektiva dhe përvoja e tyre, janë përdorur: analiza e të dhënave dytësore dhe metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave, nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar me persona kyç nga Qendra për Punë Sociale në Kërçovë.

Gjatë këtij hulumtimi shkecor janë aplikuar metodat më të përshtatshme që i përgjigjen temës së lartëpërmendur, me qëllim që arrihet deri te qëllimi i hulumtimit.

Metodat e përdorura janë: metodat kualitative, analitike, intervistes, krahasuese, deskriptive dhe empirike.

Në këtë punim do përfshihen intervista nga të punësuar pranë Qendrës për Punë Sociale në Kërçovë, gjegjësisht do të intervistohen juristë, pedagogë dhe psikologë.

Të gjithë pjesëmarrësit në intervistë u intervistuan. Arsya që vendosa vetë ta marr përsipër këtë detyrë është se gjatë intervistës dëshirorja të bëja pyetje të ndërmjetme (nënpyetje tjera) kështu u krijuan disa biseda të këndëshme.

Intervista është realizuar nëpërmjet pyetsorit. Nga rishikimi i literaturës u nxorrën disa çështje të cilat shërbyen si pikënisje për hartimin e përpilimit të intervistës. Në kapitullin e ardhëshëm janë të paraqitura të dhënat e përfthuara që më pas kanë kaluar në procesin e

përpunimit, analizës dhe të krahasimit. Ky proces ka ndikuar shumë në shmangien e gabimeve dhe në garantimin e nivelit të sigurisë së të dhënave të mbledhura.

### **6.1.1. Analiza e intervistës**

Intervista është realizuar në formë të pyetësorit. Për mbledhjen e të dhënave u mendua të përdorej një format interviste gjysmë e strukturuar duke qënë se intervistat gjysmë të strukturuar janë kryesisht të bazuara në njohuritë më të rëndësishme dhe themelore të asaj që po merret në studim.

Pyetjet të cilat janë trajtuar në intervistat gjysmë të strukturuar, kanë prekur temat e mëposhtme:

- Ndikimi i shkurorëzimit të fëmijët;
- Marrëdhëniet prind – fëmijë pas shkurorëzimit;
- Konfliktet prind – fëmijë pas shkurorëzimit;
- Impakti i prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit;

Kjo intervistë jep një pasqyrë të qëndrimit dhe të mendimit të të punësuarve pranë Qendrës për Punë Sociale në Kërçovë, rreth çështjes së prindërisë së përbashkët konkretisht pas ndarjes ose shkurorëzimit të prindërve.

Të gjithë të punësuarve të intervistuar së pari iu është marrë leje për realizimin e intervistës dhe të gjithë ishin të gatshëm për të raportuar në mënyrë korrekte dhe të drejtë për çështjet të cilat ishin të adresuara në formatin e intervistës gjysmë të strukturuar, kurse përgjigjet, që janë marrë, janë protokoluara me shkrim. Pjesëmarrësve iu është shpjeguar se ata nuk janë të detyruar të marrin pjesë në intervistë, përveçse në formë vullnetare dhe se mund të ndërpresin intervistën në çdo moment, nëse vlerësojnë se nuk dëshirojnë të ndajnë më tej përvojat dhe eksperiencën e tyre.

Informacionet janë analizuar në mënyrë konfidenciale dhe asnjë informacion nuk do të përhapet publikisht. Gjatë analizës së intervistës nuk janë përdorur emra të personave të intervistuar por vetëm profesioni i tyre.

Përgjigjet janë përmbledhur një nga një dhe në fund janë realizuar krahasime mes të dhënave të një personi me të dhënat e personit tjerër, ku janë vërtetuar ngjashmëri dhe dallime mes rezultateve të fituara.

Gjatë këtij procesi, një rëndësi të veçantë ka pasur procesi i konsultimit dhe i bashkëpunimit me tëpunshuarit pranë Qendrës për Punë Sociale që ofrojnë shërbime në fushën e familjes dhe fëmijëve.

Vlen për t'u theksuar se në maj të vitit 2020 në Kërçovë nëpërmjet një pyetësori realizuan tre intervista të përbëra nga tetë pyetje. U intervistuan një jurist, një pedagog, dhe një psikolog.

## **7 Rezultatet e intervistës**

Për realizimin e kërkimit është përdorur si instrument intervista e thelluar gjysmë e strukturua. Intervistat gjysmë të strukturuar mundësojnë fleksibilitet dhe liri në parashikimin dhe mbledhjen e informacionit.

Nënkapitujt në vazhdim janë përmbledhje e intervistave të realizuara. Rendi i përgjigjeve nuk korrespondon gjithmonë saktësisht me rendin e pyetjeve nga pyetësori, pasi në disa raste janë parashtruar nga një-dy nënpyetje tjera.

Për secilin grup pjesëmarrësish është hartuar një intervistë e veçantë pasi çështjet dhe informacioni që janë kërkuar ishin të ndryshme. Të gjithë personave të intervistuar u janë parashtruar pyetjet e njejtja me renditje të njejtë.

Rezultatet e intervistave janë përshkruar dhe janë përmbledhur një nga një. Secila intervistë më poshtë është përshkruar veçmas në mënyrë të detajuar.

### **7.1. Intervista 1**

**Nga intervista me jurist të punësuar pranë Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale – Kërçovë, e realizuar më datë 21.05.2020.**

**1. Me cilin prind mendoni se është më e arsyeshme të jetojë fëmija pas shkurorëzimit dhe pse?**

Fëmija pas shkurorëzimit mendoj dhe është e arsyeshme t'i jepet nënës, sepse deri në moshën 12 vjeç fëmija emocionalisht është më shumë i lidhur me nënën, ndërsa pas moshës 12 vjeçare merret parasysh edhe vullneti i fëmijës i cili me anë të deklaratës shpreh se me cilin prind dëshiron të jetojë. Gjithashtu, para se të përcaktojmë se me cilin prind do të jetojë fëmija marrim parasysh edhe gjendjen ekonomike të prindërit kujdestar, kushtet në të cilat do të jetojë fëmija, si rrethin social, etj. Por megjithatë e drejta prindërore u takon në masë të njejtë dhe të barabart si nënës ashtu dhe babait.

**2. Çfarë efekti mund të ketë bisedimi me fëmijët për shkurorëzimin?**

Deri në moshën 12 vjeçare fëmijët nuk merren në pyetje për shkak se deklarata e fëmijës llogaritet si deklaratë e dhënë nën presion, dhe për këtë arsye në shumicën e rasteve me fëmijët që janë deri në moshën 12 vjeçare ne nuk bisedojmë për shkurorëzimin. Ndërsa pas moshës 12 vjeç fëmija jep deklaratë në prezencë të njërit prind por, Qendra për Punë Sociale bën vlerësimin e deklaratës së fëmijës.

**3. Si ndikon shkurorëzimi në sjelljen e fëmijëve dhe çka mund t'u ndihmojë atyre?**

Shkurorëzimi si proces në vete ndikon te fëmija dhe le pasoja si emocionale ashtu dhe psikike. Shkurorëzimi në vete rrënon fëmijën dhe le çrregullime, sidomos në moshën e adoleshencës kur ato ndihen të pasigurtë si dhe jo të lumtur. Gjatë kësaj periudhe fëmijët bëhen agresiv, josocial, mbyllen në vetëvete dhe mund të krijojnë varësi të rrezikshme. Mendoj se në raste të tilla ajo që u ndihmon fëmijëve pas shkurorëzimit është që prindërit për fëmijët e tyre të kërkojnë ndihmë nga psikologë ose pedagogë.

**4. Si janë marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit?**

**- Marrëdhëniet e fëmijës me prindërin me të cilin jeton dhe me prindërin e ndarë?**

Marrëdhëniet e fëmijës me prindin me të cilin jeton mendohet se janë të mira pasi në Qendër për Punë Sociale vlerësojmë se janë të tilla ose duhet të jenë të mira, në të kundërtën

Qendra për Punë Sociale do të hulumtojë rrethanat dhe do të vendosë nëse fëmija do të qëndrojë për ruajtje dhe edukim te prindi të cilit ia ka besuar ose do të qëndrojë te prindi tjetër por, gjithashtu mund t'i besohen edhe ndonjë institucioni. Marrëdhëniet e prindit të cilit nuk i janë besuar fëmijët ka të drejtë për mbajtjen e marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte me atë. Gjithashtu, prindi të cilit nuk i besohet fëmija ka detyrimin e pagesës së alimentacionit që fëmija të ndjejë më pak mungesën e prindit me cilin nuk jeton.

***5. Cilat janë konfliktet më të shpeshta mes fëmijës dhe prindit gjatë dhe pas shkurorëzimit?***

Si konflikt më i shpeshtë mes prindërve të shkurorëzuar dhe fëmijës na paraqitet momenti kur fëmija duhet të takohet me prindin me të cilin nuk jeton për arsye se prindi të cilit i është besuar fëmija në të shumtën e rasteve nuk dëshiron që fëmija të takohet me atë dhe gjejnë arsyetime nga më të ndryshmet, si për shembull shpesh here marrin vërtetime mjeksore se fëmija është i sëmurë. Si konflikt tjetër paraqitet edhe kërkesa e prindit që nuk i është besuar fëmija për takime më të shpeshta me qëllim për mbajtjen e marrëdhënieve personale, edhe pse Qendra për Punë Sociale që prej fillimit e rregullon mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte të prindërve me fëmijët.

***6. Çka mendoni për prindërinë e përbashkët?***

Unë si jurist i punësuar pranë Qendrës për Punë Sociale rreth prindërisë së përbashkët mendoj se do të ndikonte pozitivisht edhe për fëmijët por edhe për ne si Qendër pasi që lirohemi nga obligimi që të përcaktojmë se me cilin prind do të jetojë fëmija. Nëse do të ekzistonte prindëria e përbashkët prindërit do të lirohen nga pagesa e alimentacionit, fëmijët nuk do të malltretohen nëpër institucionet e ndryshme, do të kenë zhvillim më të mirë psikik dhe gjithashtu, mendoj se raportet midis prindërve nuk do të jenë të acaruar si këto që janë për momentin.

***7. Sikur të ekzistonte prindëria e përbashkët, si do të ndikonte ajo në mirëqenien psiko-sociale të fëmijës, pas ndarjes së prindërve?***

Të ekzistonte prindëria e përbashkët në vendin tonë, fëmija do të rritej si fëmijët e tjerë pra, nuk do të ndjente mungesën e prindërve, do krijohej lidhshmëri më e qëndrueshme mes fëmijës dhe prindërve, përgjegjësia do të ishte e përbashkët, angazhimi do të ishte i dyanëshëm. Pra, thënë në përgjithësi prindëria e përbashkët është varianti më i mirë i cili do të kishte ndikim pozitiv në gjendjen psiko-sociale të fëmijës.

***8. A do të mundet prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit të krijojë lidhshmëri me të qëndrueshme midis fëmijës dhe prindërve? Si?***

Mendoj se prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit mund të krijojë një lidhshmëri më të qëndrueshme midis prindërve dhe fëmijëve duke mbajtur kontaktet e rregullta dhe në mënyrë të barabart me të dy prindërit. Edhe sikur të ekzistonte prindëria e përbashkët do të kisha thënë, që ajo të realizohet në mënyrë të njejtë për prindërit.

**7.2. Intervista 2**

**Nga intervista me Pedagog të punësuar pranë Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale – Kërçovë, e realizuar më datë 26.05.2020.**

***1. Me cilin prind mendoni se është më e arsyeshme të jetojë fëmija pas shkurorëzimit dhe pse?***

Sipas mendimit tim mendoj se më e arsyeshme dhe në gjendje të rregullt është që fëmija të jetojë me nënën por, gjithësesi duhet që të bisedohet edhe me babain, pra me të dy prindërit sepse të dy duhet të trajtohen në mënyrë të njejtë. Në bazë të trajnimeve që kemi bërë arsyja se pse fëmija duhet të jetojë me nënën është se fëmija ka lidhje të pakushtëzuar me nënën. Qendra për Punë Sociale besimin e fëmijëve te nënat e ka rreth 90% kurse te baballarët 10%. Megjithatë, para se të përcaktohet se cilit prind do t'i jepet fëmija duhet të bisedohet me të dy prindërit.

***2. Çfarë efekti mund të ketë bisedimi me fëmijët për shkurorëzimin?***

Ekzistojnë teknika dhe metoda për diagnostifikimin e nevojave se kujt prindi mund t'i besohet fëmija prej të cilave: dy teknika janë të punëtorit social, dy të psikologut dhe dy të

pedagogut. Bisedimi i Qendrës për Punë Sociale me fëmijët rreth shkurorëzimit është shumë i rëndësishëm pasi shohim gjendjen e tyre emocionale, bisedimi me fëmijët rreth shkurorëzimit gjithashtu ka karakter të rëndësishëm për shkakë se vetë fakti kur ne bisedojmë me fëmijët në rrethana natyrale, ne si Qendër dhe unë si pedagog mund të shohim më qartë gjendjen emocionale të fëmijës si dhe nga cili prind fëmija ka më tepër aspirata.

### ***3. Si ndikon shkurorëzimi në sjelljen e fëmijëve dhe çka mund t'u ndihmojë atyre?***

Parimisht nga praktika jonë si Qendrës për Punë Soiale shkurorëzimi lë shumë pasoja negative në sjelljen e fëmijëve gjatë dhe pas procesit të shkurorëzimit. D.m.th. në qoftë se prindërit hyjnë në konflikt për interesat e veta, atëherë në mes tyre qëndron fëmija që kundrejt tyre është krejtësisht i pafajshëm. Këtu në qendër kemi raste ku trajtojmë fëmijë nga mosha një vjeçare dhe deri në 18 vjeçare, këto fëmijë në shumicën e rasteve janë viktima të dhunës në familje ose konflikteve familjare. Në rastet e tilla vërehet qartë se prindërit bëhen si fëmijë kurse fëmija bëhet si prindër duke treguar pjekuri pra, shohim ndryshim të roleve, poashtu fëmijët që jetojnë në rrethana të tilla me prindër të shkurorëzuar pësojnë ngecje edhe në procesin e arsimit për arsye se përfetojnë pikëllim.

### ***4. Si janë marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit?***

#### ***- Marrëdhëniet e fëmijës me prindin me të cilin jeton dhe me prindin e ndarë?***

Marrëdhëniet e fëmijës me prindin me të cilin jeton normalisht janë më të mira përshkak se ai prind e përvetëson fëmijën, kurse marrëdhëniet me prindin me të cilin nuk jeton fëmija në shumicën e rasteve (diku rreth 50%) nuk janë të mira për arsye se ka fëmijë që nuk duan të takohen dhe të mbajnë kontakte të rregullta me prindin e ndarë. P.sh. kemi pasur një rast shumë delikat ku prindi iu drejtua fëmijës 9 vjeçar duke i bërë titur se do ta hedhë nga dritarja. Më pas fëmija përfundoi në klinikën psikiatrike në Shkup, ku ne morrëm vendim në bazë të raportit mjekësor që fëmija t'i ndërprejë krejtësisht kontaktet me prindin, në këtë rast me babain. Në këto raste ku vjen në pyetje shëndeti mental i fëmijës mendoj se ka të bëjë me një proces shumë të ndërlikuar që ne si Qendër duhet t'i qasemi me shumë kujdes.



**5. *Cilat janë konfliktet më të shpeshta mes fëmijës dhe prindit gjatë dhe pas shkurorëzimit?***

Një nga konfliktet më të shpeshta që kam vërejt është se ka prindër që refuzojnë të paguajnë alimentacion, konflikt tjetër që paraqitet shumë herë është edhe rregullimi i kontakteve të fëmijës me prindin që nuk i është besuar pasi ka shumë destruktivitet.

**6. *Çka mendoni për prindërinë e përbashkët?***

Për prindërinë e përbashkët unë si pedagog mendoj se është forma më ideale dhe më e përshtatshme për rritjen, edukimin dhe zhvillimin të mirëfillt të fëmijës. Kjo formë e prindërisë mendoj se gjithashtu paraqet një garancion më të mirë për zhvillimin psikofizik të fëmijës.

**7. *Sikur të ekzistonte prindëria e përbashkët, si do të ndikonte në mirëqenien psiko-sociale të fëmijës, pas ndarjes së prindërve?***

Unë si pedagog mendoj se po të ekzistonte prindëria e përbashkët gjithësesi se do të ndikonte në mirëqenien psiko-sociale të fëmijës si dhe në zhvillimin normal psiko-fizik të fëmijës.

- *Sikur të ekzistonte prindëria e përbashkët në çfarë mënyre do të kishit propozuar ju që të realizohet?*

Unë si pedagog do të propozoja që të realizohet 50-50 pra, fëmija të jetonte edhe me nënën edhe me babain në mënyrë të barabartë. Por si veti negative të kësaj forme të prindërisë që do të ndikonte negativisht dhe në formë jo të mirë është te foshnjat si dhe te ndjenjat e fëmijës se ku do të dëshironte të jetojë ai.

**8. *A do të mundet prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit të krijojë lidhshmëri me të qëndrueshme midis fëmijës dhe prindërve? Si?***

Prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit midis prindërve dhe fëmijëve mendoj se do të krijojë lidhshmëri më të qëndrueshme pasi fëmija nuk i humb kontaktet me asnjërin nga prindërit.

### **7.3. Intervista 3**

**Nga intervista me Psikolog të punësuar pranë Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale – Kërçovë, e realizuar më datë 27.05.2020.**

#### ***1. Me cilin prind mendoni se është më e arsyeshme të jetojë fëmija pas shkurorëzimit dhe pse?***

Ekzistojnë arsye të shumta që një çift të vendosi të divorcohet, por nëse shkurorëzimi është bërë për shkaqe dhune unë mendoj se fëmija asesi nuk duhet t'i besohet prindit dhunues këtë e shoh si kriterium primar. Prandaj, duhet të shihet qartë se me cilin prind vetë fëmija ndihet më i sigurtë atij duhet dhe t'i besohet.

#### ***2. Çfarë efekti mund të ketë bisedimi me fëmijët për shkurorëzimin?***

Unë si e punësuar pranë Qendrës për Punë Sociale dhe si psikologe mendoj se bisedimi me fëmijët për procese të tilla varet nga mosha e tyre, p.sh. nëse fëmijët janë të moshës madhore mund ta ndihmojnë procesin. Fëmija duhet të jetë i vetëdijshëm për gjendjen në familje, gjatë kësaj periudhe fëmijës duhet t'i jepet ndihmë dhe përkrahje.

- A duhet të përgatiten fëmijët mentalisht para shkurorëzimit?

Definitivisht fëmijët duhet të përgatiten mentalisht, sepse për çdo fëmijë shkurorëzimi i prindërve të tyre paraqet një traumë dhe fatëkeqësisht konfliktet e prindërve revanshohen përmes fëmijës. Para disa javësh kishim një rast ku prindërit ishin të shkurorëzuar dhe të dy vazhdonin jetën e tyre normalisht kurse fëmijët që ende nuk e kishin pranuar gjendjen e re vazhdimisht kontaktonin babain e tyre që të kthehej përsëri, pra këtu shohim se bëhet fjalë për proces të ndërlikuar ku fëmijët patjetër duhet të përgatiten një periudhë më të gjatë që të mos vijë deri te përjetimi i traumës dhe shokut.

#### ***3. Si ndikon shkurorëzimi në sjelljen e fëmijëve dhe çka mund t'u ndihmojë atyre?***

Gjatë përvojës sime si psikologe gati te çdo fëmijë, si te vajzat ashtu dhe te djemt paraqiten çrregullimet e njejta, ato bëhen më të turpshëm, më antisocial, tërhiqen në vete, nuk ndihen të barabartë në shkollë ka edhe raste ku ata bëhen edhe shumë të dhunshëm. Ajo që

mund t'u ndihmonte është ndoshta shkolla e cila duhet të punojë intenzivisht me fëmijën, rrethi social poashtu ndikon shumë. Shumë të rëndësishme e konsideroj se të dy prindërit duhet të jenë të kyçur barabar në jetën e fëmijës që ai të ndihet dhe të jetojë si gjithë fëmijët e tjerë, poashtu edhe ne si qendër, mendoj se duhet njëkohësisht dhe barabar të punojmë si me prindërit ashtu dhe me fëmijën.

#### ***4. Si janë marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit?***

##### ***- Marrëdhëniet e fëmijës me prindin me të cilin jeton dhe me prindin e ndarë?***

Pas procesit të shkurorëzimit fëmija është ai që është i ngarkuar me problemet dhe me mosmarrëveshjet midis prindërve edhe shpesh ndodh që ditë e natë të mendojë se vetë ai është fajtor për atë që ka ndodhur kjo ndarje.

Prandaj, gjatë kësaj faze ka edhe raste pozitive edhe raste negative. Megjithatë nëse arsya e ndarjes ka qenë p.sh. dhuna marrëdhëniet nuk janë aspak të rregulluara. Vlenë të theksohet se nëse dhuna është arsya e ndarjes atëherë, për fëmijën shkurorëzimi ndikon pozitivisht. Nëse fëmija i besohet prindit jodhunues marrëdhëniet midis tyre janë shumë të mira. Por nëse fëmija i besohet prindërit dhunues mund të vijë shumë shpejt deri në eskalimin e situatës. Moshën e fëmijës edhe në këtë rast e shoh si vendimtare.

#### ***5. Cilat janë konfliktet më të shpeshta mes fëmijës dhe prindit gjatë dhe pas shkurorëzimit?***

Fëmijët dinë të akuzojnë prindin. Fëmijët në këto raste janë shumë të mllëfosur dhe të hidhëruar me prindërit. Por, ka raste ku fëmijët situatën e shkurorëzimit e pranojnë shumë lehtë dhe nuk ka konflikte. Kemi pasur edhe rast ku fëmija është shumë i vetëdijshëm për pjekurinë e nënës së vet. Fëmijët gjatë fazës së adoleshencës janë më të prirur për konflikte pasi nuk mund ta përpunojnë ndarjen e prindërve dhe se shkurorëzimi i prindërve është bërë për të mirën e tyre.

#### ***6. Çka mendoni për prindërinë e përbashkët?***

Për prindërinë e përbashkët mund të them se është proces pozitiv, pasi fëmija ruan njëjtë relacionet me të dy prindërit, dashuria dhe besimi për të dy prindërit mbetet si ka qenë më përpara dhe mendoj se forma e tillë e prindërisë mundë të ndikojë që një pjesë e konflikteve, sidomos rreth përkujdesit të fëmijës të zbuten madje dhe të shmangen krejtësisht.

***7. Sikur të ekzistonte prindëria e përbashkët, si do të ndikonte në mirëqenien psikosociale të fëmijës, pas ndarjes së prindërve?***

Prindëria e përbashkët mendoj se do të ndikonte në mënyrë shumë pozitive pasi fëmija do e ndjente se i ka të dy prindërit qoftë në mënyrë të njëjtë apo në mënyrë të re, gjithësesi nuk do të ndihej si i braktisur nga ana e njërit prind. Një faktor shumë të rëndësishëm që ndikon te mirëqenia psikosociale e fëmijës e shoh dhe marrëdhëniet ndërmjet prindërve, nëse ato janë të rregulluara në një farë mënyre dhe nëse nuk ekziston fyerje midis tyre patjetër se do të ndikonte pozitivisht te fëmija. Pastaj edhe marrja e vendimeve më të rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën e fëmijës, p.sh. në cilën shkollë të mësojë, pushimet, etj., gjithmonë prindërit duhet t'i marrin bashkarisht dhe të kyçen bashkarisht në vendime. Prindërit pavarësisht se janë të ndarë ata duhet të paraqesin model pozitiv për fëmijën e tyre.

***8. A do mundet prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit të krijojë lidhshmëri më të qëndrueshme midis fëmijës dhe prindërve? Si?***

Mendoj se mund të krijojë lidhshmëri më të qëndrueshme, shkurorëzimi ka qenë situatë stresuese dhe mendojmë se pas shkurorëzimit vjen deri te zbutja dhe qetësimi i këtij stresi dhe pasi është qetësuar ky lloj stresi mendoj se ekziston mudësi për të krijuar rilidhje të reja midis prindërve dhe fëmijës, dhe fëmija të pranojë prindin me vendimin e vet.

## **8 PËRMBLEDHJA DHE KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË PËRFITUARA NGA INTERVISTAT**

### **8.1. Krahasimi i të dhënave të përfituara nga intervistat**

Nga rezultatet e studimit dhe të intervistave të realizuar me të punësuarit pran Qendrës për Punë Sociale, mund të përmenden disa fakte mjaft interesante. Në këtë kapitull do bëhet përmbledhja dhe analizimi i përbashkët i intervistave, si dhe do të mund të shihet qartë

mendimi dhe qëndrimi i të intervistuarve rreth çështjes së prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit të martesës.

**Pyetja e parë: *Me cilin prind mendoni se është më e arsyeshme të jetojë fëmija pas shkurorëzimit dhe pse?*** Të gjithë personat e intervistuarit bazuar nga përvoja e tyre ishin të mendimit se fëmija pas shkurorëzimit duhet t'i jepet nënës. Psikologja ishte e mendimit se vetë fëmija duhet të vendosë se me cilin prind ndihet më i sigurtë atij duhet dhe ti besohet. Gjendja ekonomike dhe rrethi social luajnë poashtu rol të rëndësishëm për jetën e një fëmije, sidomos kur fëmija është në moshën e adoleshencës dhe kur përballet me jostabilitet emocional.

**Pyetja e dytë: *Çfarë efekti mund të ketë bisedimi me fëmijët për shkurorëzimin?*** Thua se të gjithë personat e intervistuar theksuan se procesi i shkurorëzimit të prindërve për fëmijën është shumë stresues. Të gjithë fëmijët duhet të përgatiten për procesin e shkurorëzimit, psikologu thekson se sa më herët të fillohet me përgatitjen e fëmijëve aq më mirë do ishte si për prindërit ashtu dhe për vetë fëmijën, pasi vetë fëmijët janë ato që procesin e shkurorëzimit e përjetojnë dhe e manifestojnë në forma të ndryshme. Juristi i punësuar pranë Qendrës për Punë Sociale thekson se me fëmijët deri në moshën 12 vjeç nuk bisedojnë dhe as që merren në pyetje se me cilin prind dëshiron të jetojnë.

**Pyetja e tretë: *Si ndikon shkurorëzimi në sjelljen e fëmijëve dhe çka mund t'u ndihmojë atyre?*** Ajo që kuptovanga praktika e Qendrës për Punë Sociale shkurorëzimi lë shumë pasoja negative në sjelljen e fëmijëve gjatë dhe pas procesit të shkurorëzimit. Fëmijët të cilët janë përballuar me procesin e shkurorëzimit të prindërve shprehin një pafundësi problemesh dhe çrregullimesh në sjelljet e tyre. Te vajzat shfaqet ndjenja e fajësimimit të vetëvetes, ndjenja e mërzi dhe e frikës si edhe përpjekjet që ato bëjnë për të riparuar marrëdhëniet e vështira të prindërve. Ndërsa te djemtë shfaqjen ndjenjat e kërcënimit dhe e agresivitetit.

**Pyetja e katërt: *Si janë marrëdhëniet prind-fëmijë pas shkurorëzimit? -Marrëdhëniet e fëmijës me prindin me të cilin jeton dhe me prindin e ndarë?*** Marrëdhëniet prind – fëmijë gjatë kësaj periudhe e humbin balancin e mëparshëm. Psikologja e intervistuar merr shembull dhunën duke theksuar se fëmija asesi nuk duhet të ketë kontakt me prindin dhunues dhe se shkurorëzimi në këto raste është në favor të fëmijës, fëmija në raste të tilla është i kënaqur me

shkurorëzimin e prindërve. Pedagogu thekson se ka prindër që përvetësojnë fëmijën e tyre duke u folur keq për prindin e tjetër.

**Pyetja e pestë: *Kush janë konfliktet më të shpeshta mes fëmijës dhe prindërit gjatë dhe pas shkurorëzimit?*** Nga të dhënat e studimit rezulton se konflikt më i shpeshtë mes fëmijës dhe prindërit është rregullimi i mbajtjes së kontakteve dhe marrëdhënieve personale. Të punësuarit pranë Qendrës për Punë Sociale theksojnë se kanë thuar se çdo ditë raste ku prindin kujdestar refuzon t'i tregojë prindët të ndarë fëmijën. Si konflikt tjetër theksohet se është edhe çështja e të paguarit të alimentacionit, nga përvoja e juristit kuptohet se ka prindër që aspak nuk u intereson mirëqenia e fëmijës ndaj dhe nuk duan të paguajë alimentacionin. Vlenë për t'u theksuar se në shumicën e rasteve përveç fëmijëve që ballafaqohen me jostabilitet emocional, edhe prindërit bëhen mjaft të ndjeshëm dhe të pakontrolluar, kështu vjen shumë shpejt dhe deri te ndryshimi i roleve mes prindërve dhe fëmijës.

**Pyetja e gjashtë: *Çka mendoni për prindërinë e përbashkët?*** Nga analiza e intervistës shihet qartë se të gjithë të intervistuarit kishin qëndrim pozitiv ndaj prindërisë së përbashkët. Pedagogu ishte i mendimit se kjo formë e prindërisë ka më shumë përparësi se mangësi që ndikon në mirëqenien e fëmijës. Një plus të madh shihte në faktin se fëmija do t'i kishte kontaktet e rregulluara në formë të barabartë si me nënën ashtu dhe me babain, si mangësi theksonte se rregullimi i prindërisë me këtë formë nuk është aspak në favor të foshnjave. Forma e tillë e prindërisë ndikon edhe në zbutjen e konflikteve si dhe në një marrëdhënie më të mirë mes prindërit dhe fëmijës. Thënë tërësisht për prindërinë e përbashkët pas ndarjes së martesës të intervistuarit shprehën më shumë anë pozitive se sa negative.

**Pyetja e shtatë: *Sikur të ekzistonte prindëria e përbashkët, si do të ndikonte ajo në mirëqenien psiko-sociale të fëmijës, pas ndarjes së prindërve?*** Siç u vërtetua te pyetja paraprake, prindëria e përbashkët ndikon tërësisht në jetën e fëmijës. Edhe te kjo pyetje personat e intervistuar paraqitën mendime të ndryshme. Sa i përket gjendjes psikosociale të fëmijës psikologja e intervistuar thekson se pavarësisht gjithë rrethanave dhe gjithë stresit të përjetuar gjatë shkurorëzimit fëmija nuk do të ndihej si i braktisur nga ana e njërit prind, me kohë do të kuptonte se në mënyrë të barabartë e ka dashurin dhe kujdesin edhe nga nëna edhe

nga babai. Prindëria e përbashkët paraqitet si forma më ideale për rritjen normale, edukimin dhe zhvillimin e mirëfilltë të fëmijës.

**Pyetja e tetë: A do të mundet prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit të krijojë lidhshmëri me të qëndrueshme midis fëmijës dhe prindërve? Si?** Nga rezultatet shihet qartë se prindëria e përbashkët definitivisht krijon mardhënie më të qëndrueshme mes fëmijëve dhe prindërve. Periudha gjatë shkurorëzimit është periudhë shumë stresuese, sidomos për fëmijën. Kurse prindëria e përbashkët mund të shërbejë si rifillim i marrëdhënieve të shëndosha mes fëmijës dhe prindërit. Të punësuarit pranë Qendrës për Punë Sociale theksojnë se duke mbajtur kontakte të rregullta dhe të barabarta me të dy prindërit, të krijohet lidhshmëri më e qëndrueshme mes fëmijëve dhe prindërve.


## 9 STATISTIKA PËRSHKRUESE PËR NUMRIN E SHKURORËZIMEVE NË

### KËRÇOVË

Në këtë kapitull përfshihen disa rezultate rreth statistikave të shkurorëzimeve për tri vitet e fundit, konkretisht përfshihen të dhëna për numrin e shkurorëzimeve gjatë viteve: 2017, 2018 dhe 2019. Të gjithë të dhënat e fituara janë të paraqitura me përqindje dhe janë përmbledhur në diagrame. Të gjithë numrat dhe të dhënat janë marrë nga Gjykata Themelore e Kërçovës.

| Viti | Numri i shkurorëzimeve | Llogaritur në përqindje |
|------|------------------------|-------------------------|
| 2017 | 146                    | 35%                     |
| 2018 | 136                    | 32%                     |
| 2019 | 141                    | 33%                     |

Tabela 1: Statistika përshkruese për numrin e shkurorëzimeve në tri vitet e fundit



Diagrami 1: Statistika përshkruese për numrin e shkurorëzimeve në tre vitet e fundit

Nga statistikave të fituara mund të theksohet se gjatë tri viteve të fundit janë regjistruar gjithësej 423 shkurorëzime. Nga tabela mund të vërehet se vetëm gjatë vitit 2017 janë shënuar gjithësej 146 shkurorëzime – llogaritur në përqindje i bie diku 35%. Në vitin 2018 janë regjistruar 136 ose 32% shkurorëzime. Gjatë vitit 2019 janë shkurorëzuar gjithësej 141 çifte ose llogaritur në përqindje gjithësej 33%.

Nga statistikave mund të vërehet se gjatë vitit 2017 është regjistruar numër më i madh i shkurorëzimeve kurse në vitin 2018 statistikave tregojnë numër më të vogël të shkurorëzimeve.



## 10 PËRFUNDIMI

Shkurorëzimi i prindërve apo ndarja e tyre nuk është një ngjarje kalimtare për një fëmijë, por është një proces që zgjat për shumë vite. Pasoja më të rënda të shkurorëzimit i përjetojnë fëmijët, këto pasoja mund të jenë shumë dimensionale me ndikim për secilin prind, por mbi të gjitha për fëmijët. Gjatë kësaj periudhe fëmijët përballen me jostabilitet emocional, këto fëmijë mund të kenë rezultate të dobëta në zhvillimin shëndetshëm psikologjik krahasuar me fëmijët në familjet normale. Këto rezultate përfshijnë arritje të ulta në arsim, nivel të lartë të varfërisë, shëndet të dobët, nivel të lartë të problemeve në sjellje, simptoma depresioni, nivele të larta të konsumimit të duhanit, akoolit dhe drogës. Pas vuajtjes së këtyre pasojave fshihet konflikt prindëror, stres prindëror dhe ndryshime në strukturën e familjare. Bazuar në këtë, fëmijët që rriten me prindër të shkurorëzuar konsiderohen si fëmijë në rrezik, ky fakt ndoshta mund të arsyetohet se gjatë periudhës së shkurorëzimit prindërit tregojnë sjellje të vrazhdë dhe janë më pak të përgjegjshëm ndaj kërkesave të fëmijëve të tyre.

Shumë shpesh pas shkurorëzimit, marrëdhëniet mes fëmijës dhe prindërit përkeqësohen dhe te fëmija lindin ndjenjat e ofendimit, frika nga e ardhmja, ndjenjat e zemërimit dhe urrejtjes, trishtim, ndjenjë faji, ndjenja e dështimit por dhe probleme të llojit social.

Një ndër mekanizmat më të rëndësishëm që ndikon në ndryshimin strukturor të familjes dhe zhvillimin e mëtejshëm psiko-social të fëmijës është gjykata. Gjatë periudhës së shkurorëzimit gjykata duhet të vendosë se cili prej prindërve do të ketë kujdestarinë kryesore të fëmijës.

Koncepti i ushtrimit të së drejtës prindërore do të thotë se prindërit e plotësojnë përmbajtjen e asaj të drejte, e plotësojnë përmbajtjen e të drejtave dhe detyrimeve të cilat janë të përcaktuara në lidhje me fëmijët e tyre të mitur, respektivisht fëmijët mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore.

Edukimi dhe rritja e fëmijëve pas shkurorëzimit është një nga të drejtat më komplekse dhe duhet të theksohet se marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve janë parakusht për ngritjen e procesit të edukimit në lidhje me fëmijët.

Pas shkurorëzimit të martesës në RMV, fëmijët i besohen vetëm njërit prind ndërsa, prindëri tjetër ka të drejtën e mbajtjes së kontakteve dhe pagesës së alimentacionit dhe ky koncept nuk i përgjigjet parimit të respektimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe parimit të barazisë në ushtrimin e të drejtës prindërore, por ekzistojnë edhe forma tjera të ushtrimit të prindërisë si: prindëria e përbashët, ku të dy prindërit në mënyrë të barabartë e ndajnë kujdesin ndaj fëmijës.

Prindërit e ndarë që ndajnë kujdestari të përbashkët duhet të bien dakord për çështjet më të rëndësishme për fëmijën me marrëveshje të ndërsjelltë. Prindërit që ndajnë prindërinë e përbashkët mund në formë më të lehtë të motivojnë fëmijën. Modeli i tillë te fëmijët rrit ndjenjën se dashurohen nga të dy prindërit dhe se kanë dy shtëpi në të njëjtën kohë, gjë që mund të rrisë vetëbesimin te fëmijët. Fëmijët që rriten me prindëri të përbashkët kanë ndjeshëm më pak probleme emocionale dhe sjellje më pozitive si dhe fëmijët e tillë mund të kenë arritje më të larta në arsim.

## BIBLIOGRAFIA

Ajduković M., Radočaj, T., (2008), *Pravo djeteta na život u obitelji*, ured UNICEF-a za Hrvatsku, Zagreb.

Buss, E., *Parental Law*, Essay, The Law school, Chicago.

Brinig, F. M., (2005), *Does Parental Autonomy Require Equal Custody at Divorce?*, The University of Iowa College of Law.

Bartlett, T. K., (1999), *Child custody in the 21<sup>st</sup> century: How the American Law institute proposes to achieve predictability and still protect the individual child's best interests*, Willamette Law Review.

Baarsma, N.A., (2011), *The Europeanisation of International Family Law*, Springer, Berlin Heidelberg.

Barth-Richtarz, J., (2011), *Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung – Auswirkungen der gemeinsamen und alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedingungen der Kinder*, Springer, Wien.

Baumann, P., (2018), *Das aktuelle Scheidungsrecht-Von der Antragstellung bis zum Scheidungsausspruch*, 18. Auflage.

Brinig, M., Allen, W. A., 2011, *Do Joint Parenting Laws Make Any Difference?*, *Journal of Empirical Legal Studies*, Notre Dame Law School.

Büchler, A., (2012), *Schweizerisches Zivilgesetzbuch und Nebenerlasse*, 4. Auflage, , Helbing Lichtenhahn Verlag.

Çavdar, K., Kostadinovska, S.C., (2013), *Закон за семејството, коментари, судска практика, предметен регистар, примери за практична примена, придружни прописи и литература*, Sv. Kliment Ohridski, Skopje.

*Family Law white paper-Parents and Children Analysis of responses.*

Gashi, H., (2007), *E drejta familjare*, Prishtinë

Halla, M., (2009), *The Effect of Joint Custody on Marriage and Divorce*, IZA, Bonn.

Hatzis, T, A., *Strengthening the ties that bind: proposals for a child-centered European divorce Law*.

Jacobs, M., (2008), Familien in Trennung und Scheidung, Ministerium für Familie und Integration.

Jelavić, M., (2010), *DJECA I KONFLIKTNI RAZVODI*, Tamposit, Nedelišće, Zagreb.

Klimovski, S., Deskoska, R., Karakamisheva, T., (2011), *Уставно Право*, Prosvetno Delo Ad, Skopje.

Merkt, H., (1994), Kinderschaftsrecht im Wandel - Das Kinderschaftsrecht in den Vereinigten Staaten von Amerika, J.C.B Mohr (Paul Siebeck), Tübingen.

Mickoviq, D., (2008), *Семејството во Европа, XVI-XXI век*, Blesok, Skopje.

Mandro, B., AMeçaj, V., Zeka, T., Fullani, A., (2006). *E drejta familjare*, Tirana.

McGlynn, C., (2006), *Families and the European Union Law*, Politics and Pluralism, Cambridge University Press, Cambridge.

Nielsen, L., (2011), *Shared Parenting After Divorce: A Review of Shared Residential Parenting Research*, *Journal of Divorce & Remarriage*, Routledge, London.

Nelson, L, B., (2013), *Divorce Mediation and its Impact on Children*, MSW Clinical Research Paper Presented to the Faculty of the School of Social Work.

Parkinson, P., (2015), *Family laws and access to justice*, New York.

Richtarz, J., (2012), *Gemeinsame Elternschaft nach der Scheidung - Auswirkungen der Gemeinsamen und Alleinigen Obsorge für die Entwicklungsbedingungen der Kinder*, Springer Verlag, Wien.

Rodgers, M., (2004), *Understanding family Law*, Cavendish Publishing Limited, London.

Richards, L. J., (1999), *Children's right vs. Parent's rights: A proposed solution to the custodial relocation conundrum*.

Siebel, C. C., (2006), *Fathers and Their Children: Legal and Psychological Issues of Joint Custody*, Academic Search Premier.

Selmani, A., (2018), E drejta Familjare Bashkëkohore, ligjerata 4.

Smith, J. A., Williams, R. D., (2007), *Journal of Comparative Policy Analysis: Research and Practice- Father-friendly legislation and paternal time across Western Europe*, Oxford.

Steinbach, A., Family process, Children's and Parents' Well-Being in Joint Physical Custody: A Literature Review

Simmerer, Th., (2005), *Einflussfaktoren bei der Bewertung des gemeinsamen Sorgerechts*, Wien.

Skinner, A. D., Kohler, K. J., (2002), *Parental Rights in Diverse Family Contexts: Current Legal Developments*, National Council on Family Relations.

Trachsel, D., (2012), *Scheidung – Faire Regelung für Kinder, Wohnung und Finanzen*, 16., überarbeitete und aktuelle Auflage, Beobachter, Zürich.

Theresa, G., (2007), *Still Partners? Examining the Consequences of Post-dissolution Parenting*, American Bar Association.

Trpenovska, S. L., Mickoviq, D., Ristov, A., (2013), *Семејно право*, Blesok, Skopje.

Trpenovska, S. L., (2004), *Семејно право*, Blesok, Skopje

Omari, S., (2012), E Drejta Familjare, Tiranë.

Woelki, B, K., Braat, B., Sumner, C, I., (2005), *European Family Law in Action*, Intersentia, Oxford.

Woelki, B, K., Sverdrup, T., 2008, *European Challenges Contemporary Family Law*, Intersentia, Oxford.

Westra L., (2014), *Child Law-Children's Rights and Collective Obligations*, Springer, Heidelberg.

Woelki, B.K., Braat, B., (2005), *EUROPEAN FAMILY LAW IN ACTION, Volume III: Parental Responsibilities*, Intersentia, Oxford.

Wellenhofer, M., (2017), *Familienrecht*, 4. Auflage, C.H.Beck Verlag, München.

### **AKTET JURIDIKE**

A study into the rights and legal status of children being brought up in various forms of material or non-material partnerships and cohabitation, A Report for the attention of the Committee of Experts on Family Law by Nigel Lowe Professor of Law and Director of the Centre for International Family Law Studies Cardiff Law School, Cardiff University, United Kingdom

Bürgerliches Gesetzbuch (BGB), (2019), Mit den Nebengesetzen zum Verbraucherschutz, Mietrecht und Familienrecht, Walhalla Fachverlag, Regensburg.

Council of Europe Committee of ministries, Recommendation No. R(84) 4, (Adopted by the Committee of Ministers on 28 February 1984 at the 367th meeting of the Ministers' Deputies.

Convention on Contact concerning Children (2003)

De Giacomo, M, A., A comparative analysis of Filial Responsibility: Italy and United States.

Ligjipërfamijeni RMV-së.

The Convention on the Rights of the Child (1989)

ZGB-OR/ *Zivilgesetzbuch, Obligationenrecht, SchKG, BV und weitere Erlasse*, 10. Auflage, (2013/14), orell füssli Verlag.

## BURIME NGA INTERNETI

Konrad, P., (2019), Gemeinsames Sorgerecht beantragen: Das musst du wissen. <https://www.babelli.de/gemeinsames-sorgerecht/> (14.06.2020).

Lekgegaj, S., (2019), Impact of divorce on the behavior of children. <https://medium.com/impact-of-divorce-on-the-behavior-of-children/divorci-nuk-%C3%ABsht%C3%AB-nj%C3%AB-ngjarje-kalimtare-p%C3%ABr-nj%C3%AB-f%C3%ABmij%C3%AB-por-%C3%ABsht%C3%AB-nj%C3%AB-process-q%C3%AB-zgjat-p%C3%ABr-shum%C3%AB-9201438b32f5> (20. 04. 2020).

Mali, A., (2014), Impakti i divorcit në çrregullimin e sjelljes së fëmijëve për grupmoshat 6-10 dhe 11-18 vjeç për rrethinën e Elbasanit, Tiranë, fq. 34. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/01/Doktoratura-Adriana-Mali-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-i-Psikologji-Pedagogjiise.pdf> (10. 03. 2020).

Paper, T., (2005), Scheidungsfamilien – Das gemeinsame Sorgerecht. <https://www.grin.com/document/114508> (28. 04. 2020).

Selmani, A., (2009), Ndhima juridike pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, fq. 10. [http://www.ajls.org/doc/9.%20ASelmani Shkurorëzimi.pdf](http://www.ajls.org/doc/9.%20ASelmani%20Shkurorëzimi.pdf) (11.02.2020).

<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/192> (14.06.2020)

<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/160> (14.06.2020)